

**UDHËZIM**  
**Nr.107 datë 2.12.2002**

**PËR KRIJIMIN, SHUMËZIMIN, PËRPUNIMIN, TREGTIMIN, KONTROLLIN,  
VLERËSIMIN E FARAVE DHE FIDANËVE DHE RUAJTJEN E TRAJTIMIN E  
MATERIALIT GJENETIK BIMOR**

Në zbatim të ligjit Nr.8732, datë 24.01.2001, "Për materialin mbjellës bimor", ligjit Nr.8880, datë 15.04.2002, "Për mbrojtjen e të drejtave të seleksionerit të bimëve", ligjit Nr.8464, datë 11.03.1999, "Për standartizimin" dhe Vendimeve të Këshillit të Ministrave, Nr.154, datë.25.04.2002, "Për të drejtat dhe detyrat e Inspektoriatit të Kontrollit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve", Nr.155, datë. 25.04.2002, "Për funksionimin, të drejtat dhe detyrat e Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve", Nr.156, datë.25.04.2002, "Për organizimin dhe procedurat e kryerjes së certifikimit të materialit mbjellës bimor", Nr.157, datë. 25.04.2002, "Për kriteret e rregullat e përpunimit, ambalazhimit, ruajtjes, etiketimit dhe përmbajtjes së etiketës për materialin mbjellës bimor", me propozim të Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, udhëzon:

**KREU I**  
**PARIME TE PERGJITHSHME**

Neni 1  
**Objekti**

Ne këtë udhëzim përcaktohen rregullat dhe specifikimet teknike për prodhimin, shumëzimin, përpunimin, tregtimin, kontrollin, vlerësimin e farave dhe fidanëve dhe për ruajtjen e trajtimin e materialit gjenetik bimor, të prodhuar në vend ose të ardhur nga importi.

Neni 2  
**Subjektet**

Rregullat dhe specifikimet teknike të këtij udhëzimi kanë fuqi vepruese për të gjithë personat fizik dhe juridik, vendas ose të huaj, Institucione Kërkimore Shkençore dhe Arsimore, si dhe Organet Shtetërore të ngarkuara, të cilët do të merren me prodhimin, shumëzimin, përpunimin, vlerësimin, tregtimin, kontrollin e materialit mbjellës bimor si dhe për ruajtje dhe trajtimin e materialit gjenetik.

Neni 3  
**Kuptimi i materialit mbjellës bimor**

Në materialin mbjellës bimor përfshihen

- a. Farat e të gjitha llojeve të bimëve të kultivuara, duke përfshirë edhe ato pyjore dhe dekorative.
- b. Fidanat, copat, sythat, filizat, kalemata, zhardhokët, bulbat, tuberet, kamzat, llastunjat dhe çdo pjesë tjetër e bimës që shërben për mbjellje dhe për riprodhimin e bimëve të kultivuara, duke përfshirë edhe ato pyjore dhe dekorative.

**KREU II**  
**KLASIFIKIMI I MATERIALIT MBJELLËS BIMOR**

#### Neni 4

### **Kiasifikimi i materialit mbjellës bimor**

Me qëllim zbatimin e këtij udhëzimi materiali mbjellës bimor klasifikohet në këto klasa

a. Material mbjellës gjenetik, në të cilin përfshihen popullatat, ekotipet, bimët e kultivarëve të bimëve të ndryshme të arave, pemëtarisë, bimëve pyjore, medicinale, kerpudhat e kultivuara për ushqim, bimë dekorative etj.

b. Material mbjellës bimor i krijuar, në të cilin përfshihen të gjithë kultivarët e rinj, linjat prinderore të reja, klone të rinj, që janë krijuar nëpërmjet punës gjenetike përzgjedhse ose metoda të tjera nga Institucionet Shkençore, seleksionere, amatore të ndryshëm, si dhe nga çdo person fizik dhe juridik vendas, vetëm ose në bashkëpunim me të huaj.

- Do të konsiderohet si material mbjellës bimor i krijuar, çdo material mbjellës, që është njohur si i tillë dhe është rregjistruar sipas procedurave të parashikuara në dispozitat ligjore të ligjit Nr.8880, datë 15.4.2002, "Për mbrojtjen e të drejtave të seleksionerit të bimëve".

c. Material mbjellës bimor i riprodhuar (shumëzuar), çdo material mbjellës i cili është prodhuar duke u mbështetur në skemën e çertifikimit.

#### Neni 5

### **Kiasifikimi i prodhimit të materialit mbjellës bimor**

Prodhimi i materialit mbjellës bimor kiasifikohet sipas grupeve në vazhdim

a. Fara të bimëve të arave në fushë të hapur përjashto ato të pikës b, të këtij neni.

b. Fara të kulturave perimore, dekorative dhe luleve.

c. Fidana të drufrutorëve, pyjore dhe dekorative.

d. Materiale shumëzimi të përbërë nga tubere, bulba, rizoma dhe te ngjashme me to.

e. Të përzjera.

#### Neni 6

### **Kategoritë e farave të materialit mbjellës bimor dhe kushtet për secilën kategori**

I. Farat e materialeve të shumëzimit të paraqitura në piken a, b, dhe d, të nenit 5, ndahen në këto kategori

a. Materiali i permirësuesit (seleksionerit).

b. Kategoria P/BAZE (Superelit)

ë. Kategoria BAZE (Elite)

d. Kategoria ÇERTIFIKUAR I - re (Riprodhimi i parë)

e. Kategoria ÇERTIFIKUAR II - te (Riprodhimi i dytë)

f. Kategoria TREGTARE (Ëomerëiale), të cilat nuk përfshihen në piken a, b, c, d dhe e, të nenit 6.

II. Kushtet për secilën kategori janë

a. Kategoria P/BAZË (Superelit, linjat) administrohet nga krijuesi dhe zotëruesi i varietetit.

b. Kategoria BAZË e farave dhe materialeve të shumëzimit prodhohet nga krijuesi direkt, ose nga subjektet e tjera, sipas normave të seleksionimit për të siguruar ruajtjen e pastërtisë së varietetit.

- Fazat dhe materialet mbjellës të Kategorisë P/BAZË dhe BAZË i nënshtrohen kontrollit zyrtar dhe çertifikohen.

c. Kategoria e ÇERTIFIKUAR janë farat dhe materialet e shumëzimit të dala nga prodhimi që i perkasin kategorisë BAZË, pra janë riprodhimi i parë dhe i dytë.

- Farat dhe materialet mbjellës të Kategorisë së ÇERTIFIKUAR i nënshtrohen kontrollit zyrtar dhe çertifikohen.

d. Kategoria TREGTARE janë farat dhe materialet e shumëzimit që nuk klasifikohen në kategoritë e mesipërme. Materiali mbjellës bimor i kësaj kategorie i nënshtrohet Kontrollit Zyrtar, por nuk kërkohet çertifikata e Origjinës.

#### Neni 7

### **Klasifikimi i materialit mbjellës binior të drufrutorëve**

Materialet e shumëzimit për drufrutorë të paraqitura në piken c, të nenit 5, klasifikohen sipas kategorive të mëposhtme

a. Burimi primar (kategori Origjinale), me origjinë nga bimë të kultivuara ose të egëra (silvatike) të identifikuar, material bimor i krijuar nga seleksionuesi dhe i ruajtur nga ai, ose nga Institutet dhe personat e autorizuar prej tyre.

b. Material P/BAZE (Superelite). Material bimor i marrë nga burimi primar (Original), i ruajtur në repositoare, për tu përdorur në formimin e blikut themelor.

c. Material BAZE (elite). Material bimor i prodhuar në bilokun themelor, për tu përdorur në formimin e blioqeve mëmë.

d. Material i ÇERTIFIKUAR. Material bimor i prodhuar nga billoku mëmë që përdoret për tregtim ose në fidanishte për shartime, rrënjëzime ose për prodhimin e filizave.

- Kategoritë e mesipërme i nënshtrohen Kontrollit Zyrtar dhe çertifikimit.

#### Neni 8

### **Farat e përzierja**

Konsiderohet perzjerje, partia e farës, tuberet, bulbat, rizomat, të përbera nga dy ose me shumë specie ose varietetë, ku përqindja e përzierjes e kalon nivelin 5%. Këto parti lejohen të përdoren për prodhim foragjer, në krijimin e tapeteve ose për qëllime dekorative.

## KREU III

### **E DREJTA E RIPRODHIMIT DHE SHUMEZIMIT TË MATERIALIT MBJELLËS BIMOR**

#### Neni 9

### **Kërkesat për riprodhim e shumëzim**

Riprodhimi dhe shumëzimi i çdo kategorie të materialit mbjellës bimor lejohet të bëhet nga çdo krijues, nga Institucionet Kërkimore Shkencore dhe Arsimore, Shtetërore ose Private dhe të gjithë personat e tjerë fizik dhe juridik, vendas dhe të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre prodhuese ose tregtare, sipas dispozitave ligjore në territorin e Republikës së Shqipërisë me kusht që:

a. Të disponojnë dokumenta që vërtetojnë origjinën e materialit mbjellës bimor fillestar të lëshuar nga institucioni përkatës ose seleksioneri që zotëron varietetin dhe administron hallkat e larta.

b. Materiali mbjellës bimor që të riprodhohet dhe shumëzohet duhet të jetë i regjistruar në katalogun zyrtar të specieve dhe varieteteve në listën "A" ose "B". Këtu përjashtohen farat e përimeve dhe luleve.

c. Të sigurohet zbatimi i kushteve të domosdoshme teknike për riprodhimin dhe shumëzimin e materialit mbjellës bimor sipas specifikimeve teknike të hartuara nga Institucionet Kërkimore Shkencore apo seleksioneri. Këto metodika depozitohen në Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve(E.SH.F.F.). para fillimit të procesit të prodhimit.

d. Subjekti të jetë i pajisur me leje për ta kryer këtë veprimtari, d.m.th. të ketë leje për shumëzimin dhe riprodhimin e farave dhe fidanëve. Leja jepet nga E.SH.F.F. sipas kritereve të mëposhtme

i. I interesuari bën kërkesë me shkrim, duke përshkruar aktivitetin që do të kryejë, mjetet dhe pajisjet që disponon për prodhimin dhe përpunimin e farave dhe fidanëve. Kërkesa përmban treguesit sipas model 1, në shtojcën, bashkangjitur udhëzimit.

ii. Paraqit dokumenta që vërtetojnë aftësitë e tij personale ose personave të angazhuar në këtë veprimtari ( fotokopje e diplomës së arsimit të lartë bujqësor).

iii. Vlerësimin nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit për zotërimin e aftësisë për ushtrimin e aktivitetit për prodhimin e farave dhe fidanëve.

iv. Vërtetim të hipotekës që disponon sipërfaqe toke, ambiente, pajisje për përpunimin ose Akt – marrëveshje për marrjen me qera të sipërfaqeve të tokës dhe ambienteve përpunuese.

v. Fermerët për materialet mbjellës bimor që prodhojnë dhe përdorin për veten e tyre nuk pajisen me leje.

vi. Institucionet Kërkimore Shkencore mund të prodhojnë, shumëzojnë dhe të hedhin në tregje fara BAZE (elite), që u përkasin varieteteve të administruara prej tyre. Vendimi Administrativ ose Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, për krijimin dhe funksionimin e tyre, zë vendin e lejes së lëshuar nga E.SH.F.F.

## KREU IV TREGTIMI I FARAVE DHE FIDANEVE

### Neni 10

#### **Subjektet që kanë të drejtën e tregtimit të materialit mbjellës bimor**

Të drejten e tregtimit të farave dhe fidanëve e kanë

a. Të gjithë personat fizik dhe juridik që kanë të drejtën e krijimit të materialit mbjellës bimor dhe konkretisht Institucionet dhe çdo person fizik dhe juridik vendas dhe i huaj kanë të drejtë të shesin material mbjellës bimor të krijuar prej tyre.

b. Te gjithë subjektet që merren me riprodhimin e farave dhe fidanëve.

c. Çdo person fizik dhe juridik që ushtron aktivitetin tregtar i cili është i pajisur me leje për të ushtruar veprimtari tregtare, në të cilën është specifikuar që një nga veprimtaritë e tregtisë që do të ushtrojë është dhe tregtimi i farave dhe fidanëve.

d. Të gjitha Subjektet Tregtare për aktivitetin që ushtrojnë në tregtinë e materialit mbjellës bimor janë objekte kontrolli të strukturave të Inspektoriatit të Kontrollit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve ( I.K.SH.F.F.), si dhe janë të detyruar të vënë në dijeni në mënyrë sistematike, për kontigjentet që hedhin në treg, organet e kontroilit prane E.SH.F.F. ose Inspektore të Kontrollit të Farave dhe Fidanëve në rrethe ku ato ushtrojnë veprimtarinë.

### Neni 11

#### **Kuptimi dhe kushtet e tregtimit të materialit mbjellës bimor**

a. Quhet material mbjellës bimor i prodhuar në vend dhe e i gatshëm për tregtim, çdo prodhim i realizuar nga mbjellja për këtë qëllim dhe që e nënshtruar përpunimit, ambalazhimit, etiketimit, në përputhje me ligjin, aktet nenligjore dhe kërkesat e neneve 36, 37, 38, dhe 3(të këtij Udhëzimi).

b. Lejohet të tregtohet materiali mbjellës bimor të prodhuar në vend, kur plotësohen kushtet e mëposhtme

i. I përket specieve bimore dhe varieteteve ( kultivar, hibrid dhe klon) që janë rregjistruar në listen “A” dhe “B”, përjashto farat e primeve dhe luleve.

ii. Eshhtë i pajisur me deklaratën e konformitetit (sipas model.2) në përputhje me Ligjin Nr.8464, datë 21.03.1999, “Për standartizimin”.

iii. Dinsponon dokumentat që vërtetojnë origjinën e materialit mbjellës bi,or që tregtohet.

iv. Disponon Fletën e Analizave Laboratorike të Iëshuara nga Laboratori I E.SH.F.F. ose

nga Laboratorë të tjerë të autorizuar nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit (sipas model.3).

v. Për raste të materialit mbjellës bimor që hidhen për herë të parë në treg përveç kërkesave të mësipërme duhet të shoqërohen edhe me të dhënat e nevojshme për zonën e përhapjes dhe teknikën e kultivimit.

vi. Është çertifikuar në përputhje me Nenin 21 të këtij Udhëzimi dhe është pajisur me certifikatën e garancisë të lëshuar nga Inspektoriati I Kontrollit Shtetëror i Farave dhe Fidanëve (sipas model.4).

c. Me pajisjen e materialit mbjellës bimor me certifikatën e garancisë dhe me Etiketat Zyrtare të lëshuar nga E.SH.F.F. dhe me etiketat e prodhuesit subjekti përkatës ka të drejtë të nxjerr në treg materialin mbjellës bimor.

d. Çdo kontigjent fare, që shitet me shumicë shoqërohet me dokumenta origjinale, kurse në shitje me pakicë kontigjentet shoqërohen me faturë shitje, ku shitësi përveç sasisë, çmimit dhe vlerës, shënon treguesit cilësore sipas deklarimeve në etiketë.

e. Çdo Subjekt i pajisur me leje për të zhvilluar aktivitetin e materialit mbjellës bimor është i detyruar të mbajë rregjistër të veçantë të hyrjë-dalje, ku të shënohet rregullisht kryerja e kësaj veprimtarie.

f. Në mjediset e përpunimit dhe në lokalet e caktuara për shitje me shumicë dhe pakicë të prodhimit të materialit mbjellës bimor është e ndaluar mbajtja e prodhimeve të njëjta që nuk janë ambalazhuar, etiketuar apo destinuar për këtë qëllim.

#### Neni 12

### **Situata të jashtëzakonshme**

Ne rast fatkeqësie natyrore ose për faktorë të tjerë madhore, me autorizim të organeve të parashikuara në ligjin “Për materialin mbjellës bimor”, lejohet tregtimi dhe mbjellja e materialit mbjellës bimor me tregues cilësor nën ato të përcaktuara në specifikimet teknike (standart). Në këtë rast diferenca midis vlerës faktike nga ato të caktuara në specifikimet teknike, I rëndon gjithmone shitësit.

#### Neni 13

### **Ndalimi i tregtimit**

Ndalohet tregtimi i çdo lloj fare ose fidani të infektuar me sëmundje e dëmtues që janë objekt karantinë si dhe kur niveli i infeksionit me sëmundje dhe dëmtues është mbi kufitë e lejuar. Speciet dhe varietetet e bimëve të ndaluara me ligj janë ato që janë përcaktuar në tabelën Nr.4, bashkëlidhur këtij Udhëzimi.

#### Neni 14

### **Kërkesat dhe procedurat për importimin e materialit mbjellës bimor**

Importimi i çdo materiali mbjellës bimor, për qëllime riprodhimi, shumëzimi e tregtimi në territorin e Republikës së Shqipërisë lejohet të behet nga cilido subjekt i licencuar, me kusht që të zbatohet kërkesat dhe procedurën e mëposhtme

A. Në kalimin tranzit të mallit nga pikat e kalimit të kufirit në doganat pritëse.

1. Subjekti importues ti paraqesë inspektorit të shërbimit të mbrojtjes së bimëve, (i cili përgjigjet për kontrollin e procedurave të importit dhe eksportit të materialit mbjellës bimor) në pikën e kalimit të kufirit dokumentat si më poshtë:

a. certifikatën e origjinës dhe dokumentacionin teknik, ku në të janë shënuar treguesit eilësor të materialit mbjellës bimor.

b. certifikatën fitosanitare.

II. Inspektori I mbrojtjes së bimëve, pas kontrollit fizik të materialit mbjellës bimor dhe

verifikimit të dokumentacioni harton proces verbalin që e lejon (ose jo) të kalojë materialin mbjellës bimor në territorin e Republikës së Shqipërisë, për veprime të mëtejshme për zhdoganimin e mallit në doganën pritëse. Procesi verbal i mshahet në tre kopje dhe hartohet sipas modelit nr.5 një nga të cilat i jepet punonjësit të doganës. Mbas kësaj procedure punonjësi i doganës kryen veprimet e mëtejshme për kalimin e mallit (materialit mbjellës bimor) tranzit për në doganat pritëse.

III. Inspektori i shërbimit të mbrojtjes së bimëve, mbas hartimit dhe firmosjes së proces verbalit për lejimin e kalimit në pikën kufitare të materialit mbjellës bimor, informon menjëherë inspektorin e farave dhe fidanëve të rrethit ku pritet të zhdoganohet materiali mbjellës bimor, si dhe Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve (Inspektoriati i Kontrollit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve), për farat dhe fidanat që kanë hyrë në kufi dhe subjektin importues.

IV. Në ato raste kur inspektori i mbrojtjes së bimëve (karantinës), për kontigjente të caktuara, konstaton dyshime për llojin e materialit mbjellës bimor (farëra ose fidana), të bimëve narkotike, që ndalohen me ligj të futen në territorin e Republikës së Shqipërisë, ka të drejtë të kërkojë poseduesit të mallit dokumentat plotësuese, ose bën bllokimin e mallit. Bllokimi i mallit bëhet me proces verbal të rregullt, një kopje e të cilit e depoziton në Drejtorinë e Doganës, një e mban punonjësi i Mbrojtjes së Bimëve dhe një i dërgohet Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve (Inspektoriati) për veprime të mëtejshme. Në këtë rast autoritetet doganore mbështesin Inspektorët e Mbrojtjes së Bimëve (karantinës) për bllokimin dhe konservimin e materialit mbjellës bimor të bllokuar deri në zgjidhjen e problemit.

B. Për zhdoganimin e materialit mbjellës bimor

I. Për çdo kontigjent material mbjellës bimor (farëra dhe fidana, përfshi edhe lulet dhe bimët dekorative), i cili ka kaluar tranzit nga pika e kalimit në doganën pritëse, para se të bëhen veprimet nga punonjësi i doganës (firmosjes së deklaratës së zhdoganimit), kontrollon fizikisht mallin dhe dokumentacionin teknik që shoqëron atë nga inspektori i Kontrollit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve që vepron në këtë rreth, i cili mbulon edhe detyrën e kontrollorit, i kërkon subjektit importues dokumentat si me poshtë:

a. Çertifikatën e origjinës dhe dokumentacionin teknik ku janë shënuar treguesit cilësor të materialit mbjellës bimor

b. Çertifikatën fitosanitare.

c. Kontratën apo akt-marrëveshjen me subjektin e huaj që ka shitur mallin.

d. Çertifikatën dhe etiketat për materialin mbjellës bimor që është përfshirë në katalogun e OECD-se (Organizata për Zhvillim dhe Kooperim Ekonomik).

e. Proces verbalin “Mbi kontrollin e materialit mbjellës bimor në pikat e kalimit të kufirit dhe lejimit të tij për kalimin tranzit në doganat pritëse”, hartuar dhe firmosur nga Inspektori i shërbimit të mbrojtjes së bimëve në pikën e kalimit të kufirit.

II. Pas kontrollit fizik të mallit dhe të dokumentave shoqëruese, sipas pikave a,b,c,d, dhe e, të këtij neni e pasi Inspektori i farave dhe fidanëve bindet që materiali mbjellës bimor duhet zhdoganuar, merr mostrën për analizë (përveç fidanëve). Menjëherë mbas kësaj harton proces verbalin, “Mbi kontrollin e materialit mbjellës bimor në pikat doganore dhe lejimin e tij për kryerjen e veprimeve të mëtejshme për zhdoganimin e tij”, sipas model. 6, në të cilin përcaktohet që materiali mbjellës bimor i plotëson kërkesat e ligjit “Për materialin mbjellës bimor” dhe i hap rrugë punonjësit të doganës për veprime të mëtejshme për zhdoganimin e mallit. Një kopje të proces verbalit e mban punonjësi i doganës një subjekti importues dhe një inspektori i farave dhe fidanëve.

Ky i fundit mban në dokumentat e tij dhe një fotokopje të gjithë dokumentacionit teknik që shoqëron mallin.

Mbas hartimit dhe firmosjes së proces — verbalit të mësipërm (Model. 6), punonjësi doganës kryen veprimet e mëtejshme për zhdoganimin e mallit.

III. Në ato raste kur Inspektori i Kontrollit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, për kontigjente të caktuara, konstaton dyshime për llojin e materialit mbjellës bimor (farëra ose fidan

: për bimë narkotike. ndalohen me ligj të futen në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht se ka kaluar tranzit nga pika kufitare, ka të drejtë ti kërkojë poseduesit të mallit dokumentat plotesuese ose bën bllokimin e mallit. Bllokimin e mallit e bënë proces-verbal të rregullt, një kopje e të cilit e depoziton në Drejtorinë e Doganës, një e mban Inspektori i farave dhe Fidanëve dhe një i dërgohet Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanave (Inspektoriatit) për veprime të mëtejshme. Në këtë rast autoritetet doganore mbështesin inpektorët e farave dhe fidanëve për bllokimin dhe konservimin e materialit mbjellës bimor të blikuar deri në zgjidhjen e problemit.

IV. Në rastin, kur materiali mbjellës bimor, sidomos për fidanat frutore, apo pyjore, që në rrugë vizuale konstatohet se nuk i përmbushin kërkesat teknike, atëherë inspektori i Kontrollit Shtetëror të Farave dhe Fidanave, shënon qartë në proces verbal që materiali mbjellës bimor të zhdoganohet, por do të bllokohet në mjediset e subjektit importues për veprime të mëtejshme.

V. Kur ëçdoganimi i mallit (fara dhe fidana), bëhet direkt në doganat e pikave të kalimit të kufirit, inspektori i shërbimit të mbrojtjes së, bimëve njofton menjëherë inspektorin e farave të rrethit për kryerjen e veprimeve për zhdoganimin.

VI. Me hartimin dhe firmosjen e proces verbalit “Mbi kontrollin e materialit mbjellës bimor në pikat doganore dhe lejimin e tij për kryerjen e veprimeve të mëtejshme për zhdoganimin e tij”, subjekti posedues i materialit mbjellës bimor, pasi kryen detyrimet doganore sipas ligjit, ka të drejtë të transportojë mallin në objektet e tij, por nuk ka të drejtë të shpërndajë dhe të shesë materialin mbjellës bimor, pa kryer çertifikimin e tij çertifikimi bëhet sipas kërkesave të pikave B dhe D të nenit 21 të këtij udhëzimi.

VII. Inspektorët e shërbimit të mbrojtjes së bimëve dhe inspektorët e farave dhe fidanëve, evidentojnë të gjitha kontigjentet e materialit mbjellës bimor që importohet duke mbajtur rregjistrin e importit eksportit të materialit mbjellës bimor si dhe informojnë rregullisht Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve. Treguesit sasior të rregjistruar duhen të përputhen me treguesit sasior të doganes.

C. Për eksportimin e materialit mbjellës bimor.

I. Eksportimi i materialit mbjellës bimor, për qëllim riprodhimi, shumëzimi e tregtimi, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, lejohet nga çdo subjekt i liçensuar nga Organet Tatimore, që gëzon të drejtën e eksportit të mallrave, me kusht që të zbatojë edhe kërkesat e mëposhtme

a. Të disponojë dokumentacionin e nevojshem sipas pikave A të nenit 21 për farat dhe pikës C të nenit 21 për fidanat. Mbi bazë të këtij dokumentacioni, Kryeinspektori lëshon çertifikatën e garancise në gjuhën angleze.

b. Materiali mbjellës bimor të jetë ambalazhuar dhe të jetë pajisur me Etiketat Zyrtare lëshuar nga Enti Shtetëror të Farave dhe Fidanëve.

c. Të jetë pajisur me Fletë-Analizë Zyrtare lëshuar nga Laboratori i Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve. Fletë-Analiza Zyrtare do të jetë sipas kërkesave të ISTA-s, në gjuhën shqip dhe anglisht sipas (Model.3/1).

d. Të ketë Çertifikatën fitosanitare, lëshuar nga Inspektori i Mbrojtjes së Bimëve.

II. Me dokumentat e niesiperm, disponuesi i materialit mbjellës bimor (ose transportuesi paraqitet në pikat e kalimit të kufirit (dogane), ku Inspektori i Mbrojtjes së Bimëve (karantinës), pasi bindet se dokumentacioni është i plotë, harton proces-verbalin që e lejon (ose Jo) materialin mbjellës bimor të dal jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (Model 5/1).

## KREU V PËR KONTROLLIN E CILESISE TE MATERIALIT MBJELLES BIMOR

Neni 15  
**Organet Shtetërore të Kontrollit.**

Organizimi dhe kompetencat e tyre.

Për kontrollin e zbatimit të rregullave dhe kriterëve të percaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore për materialin mbjellës bimor krijimin riprodhimin, shumëzimin, tregtimin dhe importimin e materialit mbjellës bimor. Pranë Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, funksionon Inspektoriati i Kontrollit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve ( I.K.SH.F.F.) struktura e të cilit është si më poshtë

a. I.K.SH.F.F. përbëhet nga Krveinspektori. Inspektorët në qënder sipas numrit ekzistues të miratuar (inspektorët në rrethet e Drejtorive të Bujqësisë dhe Ushqimit

b. Në Drejtoritë e Bujqësisë dhe Ushqimit të rrethëve Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Mat, Lushnjë, Vlorë, Gjirokastër, Sarandë, Kavajë, Tiranë, Kukës, Shkodër, Korçë dhe Dibër kanë në strukturën organike të tyre një Inspektor për Farat dhe Fidanët.

c. Në rrethet e tjera kur nuk është parashikuar në strukturën organike Inspektori i veçantë për farat e fidanat, këtë detyrë e kryen një specialist i ngarkuar nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit të Rrethit.

d. Inspektorët e I.K.SH.F.F. dhe personat e tjerë të autorizuar pajisen me autorizim të lëshuar nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit , i cili përmban, identitetin e Inspektorit, fotografinë, nënshkrimin e Ministrit dhe vulën e kësaj Ministrie.

e. Në pikat e kalimit kufitar (Dogana). Inspektorët e Shërbimit të Mbrojtjes së Bimëve (karantinës), ngarkohen dhe përgjigjen edhe për kontrollin e procedurave të importit dhe eksportit të materialit mbjellës bimor.

Ata informojnë menjëherë, për çdo kontigjent të materialit mbjellës bimor që importohet, Inspektorët e rrethëve përkatëse dhe Inspektoriatin në Qendër pranë E.SH.F.F.

f. Inspektoriati Shtetëror i Kontrollit të Farave dhe Fidanëve është organ qendror që përgjigjet për organizimin dhe drejtimin e kontrollit të zbatimit të ligjshmërisë për materialin mbjellës bimor, në territorin e Republikës së Shqipërisë. Administrativisht ai varet nga Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve.

Ai koordinon dhe mbikqyr të gjithë punën e organizmave të tjera që kanë detyrime ligjore për materialin mbjellës bimor.

g. Inspektoriati Shtetëror i Kontrollit të Farave dhe Fidanëve është i vetmi organ që lëshon çertifikatën e garancisë si dokument që vërteton konformitetin cilësive të materialit mbjellës bimor. Çertifikimi bëhet sipas procedurave të percaktuara në nenin 21 të këtij Udhëzimi.

h. Për mangësitë dhe mungesën e përgjegjësisë në kryerjen e detyrave nga personat e ngarkuar, Inspektoriati u propozon organeve përkatëse, marrjen e masave administrative.

Neni 16

### **Fushat e ushtrimit të kontrollit.**

Kryeinspektori, inspektorët e këtij shërbimi, si dhe personat e autorizuar, ushtrojnë kontroll në të gjitha instancat ku prodhohet, riprodhohet, shumëzohet, përpunohet, transportohet e tregtohet çdo lloj materiali mbjellës bimor dhe konkretisht

a. Në ngastrat e prodhimit të farës dhe në fidanishte.

b. Në magazinat, lemenjtë, mjediset ku përpunohet dhe ruhet materiali mbjellës bimor.

c. Në mjetet transportuese të materialit mbjellës bimor.

d. Në njesitë dhe pikat e shitjes të materialit mbjellës bimor.

e. Në ngastrat e vlerësimit të varieteteve të rinj, në ngastra dhe blloqe që ruhen bim origjinale dhe hallkat e larta si dhe në ato të prodhimit të gjerë.

f. Në pikat e kalimit të kufirit dhe në doganat ku behen veprime zhdoganimi të materialit mbjellës bimor.



Neni 17  
**Detyrat e I.K.SH.F.F.**

- I. K.SH.F.F. pranë Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve ka për detyrë të kontrollojë:
- a. Zbatimin e dispozitave të ligjit “Për materialin mbjellës bimor”, teë ligjit “Për seleksionerit të bimëve”, dhe zbatimit të gjithë dispozitave të akteve nënligjore që rrjedh ligje.
  - b. Zbatimin e specifikimeve teknike për materialin mbjellës bimor të Tabelave Nr.1, 2, 3, bashkangjitur).
  - c. Respektimi i rregullave fito-sanitare që lidhen me pastërtinë e materialit mbjellës bimor Për këtë bashkëpunon me Shërhimin e Mbrojtës së Bimëve.
  - d. Respektimin e kushteve të domosdoshme agroteknike në ngastrat e prodhimit riprodhimit dhe shumëzimit të farave dhe fidanëve sipas metodikave apo teknologjive të hartuara nga Institutet kërkimore Shkencore apo seleksioneri, të depozituara në E.SH.F.F. para fillimit të procesit të mbjelljes

Neni 18  
**Dokumentacioni teknik**

Institucionet Kërkimore Shkencore dhe Arsimore, shtetërore ose private dhe të gjithë personat e tjerë fizikë dhe juridik, vendas dhe të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre për prodhimin, shumëzimin dhe tregtimin e materialit mbjellës bimor janë të detyruar të mbajnë dhe të venë në dispozicion të I.K.SH.F.F. në çdo kohë këto dokumenta teknike

- a. Lejen për të ushtruar aktivitetin krijues, prodhues, tregëtar për materialin mbjellës bimor të lëshuar nga Organet e ngarkuara me ligj.
- b. Lejen e lëshuar nga E.SH.F.F. që iu jep të drejtën për riprodhimin, shumëzimin dhe përpunimin e materialit mbjellës bimor.
- c. Lejen ose autorizimin e pronarit kur varieteti është në pronësi.
- d. Dokumenti që vërteton origjinin dhe pastërtinë gjenetike të materialit mbjellës bimor fillestar, fare ose material shumëzimi vegjetativ.
- e. Ky dokument të jetë origjinal i lëshuar nga seleksioneri ose subjekti që zotëron hallkën e lartë të varietetit përkatës. Vendin e këtij dokumentacioni e zë certifikata e garancise e lëshuar nga organi zyrtar i kontrollit të farave dhe fidanëve.
- f. Materiali mbjellës bimor që riprodhohet, shumëzohet apo tregtohet të jetë i regjistruar në Katallogun Zyrtar të Specieve dhe Varieteteve në listën “A” ose “B”, përjashto farat e perimeve dhe të luleve.
- g. Të ketë certifikatën fitosanitare të lëshuar nga Inspektori i Shërbimit të Mbrojtjes të Bimëve e cila vërteton se materiali fillestar dhe shumëzues është i pastër nga ana fitosanitare.
- h. Të ketë Fletën e Analizave Laboratorike të lëshuar nga Laboratori Qendror i Testimit të Farave pranë E.SH.F.F. ose Laboratorë të tjerë të autorizuar nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.
- i. Fleta e Analizave zyrtare lëshohet vetëm për rezultatet e mostrave të marra dhe të dorëzuara nga inspektori përkatës. Analizat private nuk kanë vlerë për certifikimin e kontigjentit.
- j. Të depozitohet kërkesa për njohjen e Qendrës së Shumëzimit (Pemëtores mëmë) dhe ajo për të fituar certifikimin gjenetik të materialit të prodhuar në fidanishte.
- k. Të disponojnë dokumentat e inspektimeve fushore ku vërtetohet plotësimi i kërkesave teknike në riprodhimin dhe shumëzimin materialin mbjellës bimor sipas teknologjive të hartuara (Model. 7 dhe 8).
- l. Të disponojë akt-aprobimin e lëshuar nga Grupi i përbërë me specialiste të Inspektoriati të Kontrollit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve (Modeli 9).

## Neni 19

### **Organet që vendosin masa administrative**

Në bazë të ligjit “Për materialin mbjellës bimor”, organet që kanë te drejtë të vendosin masa administrative janë

a. Kryeinspektori i Farave dhe Fidandve, Inspektoret e këtij Inspektoriati si dhe ëdo person tjetër i autorizuar nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit për vendosjen e masës së gjobes dhe te bllokimit.

b. Kryeinspektori për vendosjen e masës të sekuestrimit të asgjesimit ose të kalimit për konsum, kur materiali mbjellës bimor percaktohet i konsumueshëm (Model. 11). Për këtë qëllim ngrihet një Komision Vlerësimi me 5 specialiste të E.SH.F.F.

c. Materiali mbjellës bimor i sekuestruar administrohet nga E.SH.F.F. në përputhje me legjislacionin në fuqi për sekuestrimet. Ai mbahet në magazina të marra me qera në ambjentet e rezervave të shtetit ose subjekteve të tjera.

d. Për të realizuar procedurat e sekuestrimit ose asgjesimië në rast nevojë kërkohet ndihma Organeve të Rendit dhe Tatim Taksave.

e. Kundër vendimit të dhënë nga Inspektori bëhet ankesë me shkrim brenda 10 ditëve nga data e shpalljes tek Kryeinspektori i I.K.SH.F.F. Kundër vendimit të dhënë nga Kryeinspektori bëhet ankesë me shkrim brenda 10 ditëve nga data e shpalljes ose njoftimit, tek Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

f. Procedurat e ekzekutimit të gjobës bëhen në përputhje me ligjin Nr.7697, datë 07.04.1993, “Për kundravajtjet administrative”.

g. Veprimet e inspektorit për vendosjen e masave administrative bëhen të argumentuara dhe jepen me shkrim sipas proces-verbalit që i bashkangjitet këtij udhëzimi.(Model. 10)

h. Në ato raste kur është mundësia e riparimit të problemit lihet afat për korrigjim dhe vetë i interesuari e vë në dijeni inspektorin, i cili pasi e rikontrollon i jep leje për veprim ose mosveprim të metejshëm.

j. Në rastet kur inspektori vëren që për qëllime fitimi ose motive të tjera mashtrimi në kultivare, hibride, linja, kategori, etj., urdhëron bllokimin e menjëhershëm të materialit mbjellës bimor dhe propozon në organe kompetente për ndjekje penale.

k. Kur vërehet se mbillet dhe tregtohet farë ose çdo lloj materiali mbjellës bimor, që prodhon lëndë narkotike, bën bllokimin e çdo kontigjenti, si dhe bën kalizimin në organet e antidrogës. Inspektorët e I.K.Sh.F.F. dhe personat e tjerë të autorizuar nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit, për kryerjen e detyrave të ngarkuara sipas perëcaktimit në dispozitat e ligjit 8732 “Për materialin mbjellës bimor”, ligjit nr.8880 “Për mbrojtjen e të drejtave të seleksionimit të bimëve” dhe gjithë akteve ligjore që rrjedhin prej tyre, përgjigjen zyrtarisht para organit administrativ që i ka në vartësi direkte.

Të gjithë punonjësit që perfshihen në strukturën organizative të I.K.Sh.F.F., sipas nenit 15, të këtij Udhëzimi, jane të detyruar tu përgjigjen në kohë kërkesave që lidhen me zbatimin e ligjshmërisë.

Për çdo shpërdorim dhe tejkalim të kompetencave që u japin aktet ligjore dhe nënligjore të mësipërm përgjigjen jo vetëm administrativisht por edhe ligjërisht.

1. Inspektoret e I.K.SI-I.F.F. dhe personat e tjerë të autorizuar mbrohen me ligj si të gjithë inspektorët e sektorëve të tjerë dhe në përmbushjen e detyrës në rast nevojë, kërkojne ndihmën e Organeve të Rendit dhe Tatim - Taksave.

## Neni 20

### **Masa administrative të Inspektoratit.**

Kur vërehen shkelje të dispozitave të parashikuara në ligjin “Për materialin mbjellës bimor”, në ligjin “Për mbrojtjen e të drejtave të seleksionerit të bimëve”, Inspektoret e

I.K.SH.F.F. si dhe personat e tjerë të autorizuar nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit, marrin këto masa administrative:

A. Në prodhimin e materialit mbjellës bimor.

a. Kur një subjekt prodhon material mbjellës bimor dhe nuk është pajisur me leje nga Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve, inspektori ka të drejtë të gjobisë nga 50.000 den në 300.000 lekë dhe të bllokojë materialin mbjellës bimor deri në plotësimin e kërkesave ligjore.(Ligji Nr.8737, datë.24.01.2001, neni 5, shkronja d).

b. Kur një subjekt prodhon material mbjellës bimor pa autorizim të pronarit, nëse varieteti është në pronësi, atëherë materiali mbjellës bimor sekuestrohet, ose kalon për konsum, nëse është i konsumushëm. (Ligji Nr.8732, datë.24.01.2001, neni 5, shkronja a) dhe vendoset një gjobe 20-30.000 lekë për çdo 100.000 lekë të vlerës së sasisë së materialit mbjellës bimor.

c. Kur subjekti prodhues nuk disponon dokumentat që verteton origjinën e materialit mbjellës bimor dhe dokumentacionit tjetër Sipas pikës A/a, C/a të nenit 21 të këtij Udhëzimi, atëherë bilokohet deri në plotësimin e kërkesave ligjore (Ligji Nr.8732, dt.24.01.2001, neni 5 shkronja b, neni 8 shkronja c) ose vendoset një gjobë 20-30.000 lekë për çdo 100.000 lekë të vlerës së sasisë së materialit mbjellës bimor.

d. Kur materiali mbjellës bimor i prodhuar, nuk është regjistruar në katalogun zyrtar në listën A” dhe B” (përfshirë perimet dhe lulet), atëherë sekuestrohet (Ligji Nr.8732, datë.24.01.2001, neni 5, shkronja c) ose vendoset një gjobë 20-30.000 lekë për çdo 100.000 lekë të vlerës së sasisë së materialit mbjellës bimor.

e. Kur materiali mbjellës bimor, futet në kategoritë e bimëve narkotike, atëherë materiali sekuestrohet. (bazuar ne Ligjin nr.8732, datë.24.01 .2001, neni 6) dhe njoftohen organet e rendit, për veprime të mëtejshme.

f. Ne Republikën e Shqipërisë ndalohet kultivimi i hashashit (Papaver somniferum), i kokës

( Erythroxylon ëoëa) dhe i kerpit indian (Cannabis sativa var.indica) (neni 9, ligji 7975, datë.26.07. 1995, “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrofe”). Për bimët e mësipërme ndalohet fütija e çdo lloj materiali mbjellës që shërben për riprodhimin ose kultivimin e tij.

g. Kur për materialin mbjellës bimor, gjatë magazinimit, përpunimit dhe amballazhimit nuk respektohen rregullat për ruajtjen e pastërtisë varietore, atëherë nga Inspektori vendosen masa administrative deri ne skualifikimin si material mbjellës bimor.

B. Në tregtimin e materialit mbjelles bimor.

a. Kur një subjekt tregton material mbjellës bimor dhe nuk është pajisur me deklaratën e konformitetit, inspektori ka të drejtë të gjobisë nga 20.000 deri në 30.000 lekë për çdo 100.000 lekë të vlerës së mallit ose të sekuestrojë, asgjesoje dhe të kalojë për konsum materialin mbjellës bimor (Ligjin nr.8732, dt.24.01.2001, neni 8, shkronja b).

b. Kur një subjekt tregton material mbjellës bimor dhe nuk disponon fletën e analizave laboratorike, atëherë materiali mbjellës bimor bliokohet deri ne plotësimin e kërkesave (Ligjin nr.8732, datë.24.01.2001, neni 8 shkronja ç). ose vendoset një gjobë 20-30.000 lekë për çdo 100.000 lekë të vlerës së sasisë së materialit mbjellës bimor.

c. Kur subjekti tregtar nuk disponon dokumentat që vërtetojnë origjinën e materialit mbjellës bimor, atëherë bilokohet deri në plotësimin e kërkesave ligjore (Ligjin nr. 8732, datë.24.01.2001, neni 8, shkronja ë ) ose vendoset një gjobë 20-30.000 lekë për çdo 100.000 lekë të vlerës së sasisë së materialit mbjellës bimor.

d. Kur materiali mbjellës bimor qe tregtohet, nuk është regjistruar në Katalogun zyrtar në listën “A” dhe “B” (përfshirë perimet dhe lulet), atëherë sekuestrohet, asgjesohet, ose kalon për konsum. (Ligji Nr.8732, dt.24.01.2001, neni 8, shkronja a) dhe vendoset një gjobë 20-30.000 lekë për çdo 100.000 lekë të vlerës së sasisë së materialit mbjellës bimor.

e. Për shkelje të dispozitave të ligjit Nr.8880, datë.15.04.2001, neni 36, shkronja a dhe b., kur prodhohet dhe shumëzohet materiali mbjellës bimor pa të drejtën e zotëruesit (subjektit që ka në pronësi vërtetimi), atëherë vendoset një gjobë nga 50.000 — 150.000 lekë.

f. Kur një subjekt apo individ tregton material mbjellës bimor i cili nuk shoqerohet me etiketat Zyrtare apo në fishet e Kontrollit, sipas nenit 21 të këtij udhëzimi, atëherë materiali mbjellës bimor, bilokohet den në plotesimin e kërkesave ose vendoset gjobë 20-30.000 lekë, per çdo 100.000 lekë të vlerës së sasisë së materialit mbjellës bimor.

#### Neni 21

### **Kërkesat dhe procedurat per çertifikimin e materialit mbjellës bimor**

Çertifikimi është procedura për pajisje me çertifikatë për treguesit sasiore dhe cilësor të materialit mbjellës bimor, i cili konfirmon se materiali mbjellës bimor plotëson kërkesat teknike dhe lejohet të tregtohet për përdorim për mbjellje, si dhe i tillë është i detyrueshëm për çdo material mbjellës bimor që hidhet në treg.

A. çertifikim i farave të prodhuar në vend

a. Kërkesat për çertifikimin e farave

i. Të vërtetohet me dokumentacion, zbatimin e kërkesave agroteknike sipas metodikave të hartuara për riprodhimin dhe shumëzimin e materialit mbjellës bimor (Model. 8).

ii. Të vërtetohet pastërtia gjenetike e varietetit nëpërmjet çertifikatës së origjinës (Model 12).

iii. Të vërtetohet pastërtia fitosanitare e materialit mbjellës bimor lëshuar nga Inspektori i Mbrojtjes së Bimëve.

iv. Dokumenti nëse është kryer Aprobimi fushor (Model. 9).

v. Flet-Analiza laboratorike të treguesve cilësor, lëshuar nga Laboratori i Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, ose nga laborator tjetër të autorizuar nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit (Model. 3).

vi. Materiali mbjellës bimor të jetë ambalazhuar dhe etiketuar me etiketën e prodhuesit (Model. 13).

vii. Subjekti prodhues lëshon deklaratën e konfirmimit (Model. 2).

viii. Për farat e riprodhimit PARABAZE (Superelite), që prodhohen nga Institucionet Shkencore Publike ose private, aprobimi fushor i tyre bëhet nga ekspertë të miratuar nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

Ekspertet e mësipërm, pas kontrollit dokumentar dhe fushor konfirmojnë se materiali mbjellës bimor është prodhuar sipas skemës së miratuar dhe ruan pastërtinë gjenetike dhe riprodhimin e përcaktuar.

b. Procedurat e çertifikimit

i. Mbështetur në dokumentacionin e mesipërm, subjekti prodhues bën kërkesë pranë Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, që të çertifikohet materiali mbjellës bimor.

ii. Mbi bazë të kërkesës, Inspektorët e ngarkuar nga Enti bëjnë verifikimin e dokumentacionit dhe shikojnë në vend kontigjentin e materialit mbjellës bimor, që do të çertifikohet dhe pasi krijojnë bindjen, hartojnë proces — verbalin, “Mbi verifikimin e specifikimeve teknike, dokumentacionit si dhe kontrollin e cilësisë së farës” (Model. 17/1 ).

iii. Inspektorët e ngarkuar, mbi bazë të proces-verbalit dhe me dokumentacionin e mesipërm përgatisin dosjen e çertifikimit.

iv. Mbi bazë të vlerësimit të dosjes Kryeinspektori lëshon çertifikatën e garancisë (model. 4), në të cilën shënohet edhe sasia dhe numuri i sense të etiketave zyrtare që i jepen subjektit prodhues.

v. Etiketa Zyrtare ngjitet në çdo njësi ambalazhimi (thes, qeske) dhe jepen në serinë e përcaktuar në çertifikatën e garancisë.

vi. Forma, dimensionet, përmbajtja dhe ngjyra e etiketës janë sipas Modelit. 15. Cilësia e Etiketës Zyrtare do të përmbaje elemente sigurie.

vii. Etiketat Zyrtare shoqërojnë materialin mbjellës bimor, në çdo njësi ambalazhimi, nga prodhues në hallkat ndërmjetëse tregtare, deri tek përdoruesi dhe vërtetojnë se materiali mbjellës

bimor është çertifikuar.

viii. Çertifikata e garancisë lëshohet pasi të jetë likujduar tarifa e çertifikimit dhe janë plotësuar dhe tërhequr nga subjekti, sasi të e Etiketave Zyrtare.

#### **B. Çertifikim i farave i ardhur nga Importi**

a. Kërkesat për çertifikimin e farave

i. Akt – marrëveshja me subjektin e huaj nga importohet fara, ku të jenë specifikuar specia, varieteti, kategoria, sasia.

ii. Çertifikata e origjinës nga shteti importues.

iii. Çertifikata fitosanitare nga shteti importues.

iv. Farat të jenë të ambalazhuar dhe të etiketuar ku treguesit e etiketës duhet të korrespondojnë me treguesit e çertifikatës shoqëruese.

v. Deklaratën e konformitetit për importimin e faëes (model 2).

vi. Flet-Anal

iza laboratorike te treguesve ëilësor, lëshuar nga Laboratori i Entit Farave dhe Fidanëve, ose nga laborator tjetër të autorizuar nga **Ministri i Bujqësisë dhe U (Model. 3)**.

vii. Proçes verbalin “Mbi kontrollin e materialit mbjellës bimor në pikat doganore lejimit të tij për kryerjen e veprimeve të mëtejshme për zhdoganim (Model. 6)

viii. Kërkesa e subjektit për çertifikimin e kontigjentit të farës. Proçedurat e çertifikimi

i. Pasi inspektori i farave dhe fidanave merr mostrën për analizë në pikën doga dërgon atë në Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve. për analizë së bashku me dokumentacionin sipas pikës B, të nenit 14 të këtij Udhëzimi, krijohet dosja e çertifikimit.

ii. Në bazë të vlerësimit të dosjes lëshohet nga K/Inspektori, Çertifikata e garancisë (Model. 14), në të cilën shënohet dhe numri i serisë të fishës së kontrollit dhe është likujduar tarifa e çertifikimit.

iii. Fisha e kontrollit vendoset në njësitë e ambalazhimit në jo më pak se 10% e lotit.

iv. Çertifikata e garancisë lëshohet pasi të jetë likujduar tarifa e çertifikimit dhe janë plotësuar dhe tërhequr nga subjekti, sasinë e Fishave zyrtare.

C. Çertifikimi i fidanave të prodhuar në vend

a. Kërkesat për çertifikimin e fidanave

i. Të vërtetohet me dokumentacion, zbatimi i kërkesave agroteknike sipas metodikave të hartuara në fidanishte (Model. 8, Model. 9).

ii. Të disponohet proces-verbali në të cilën përcaktohet së zotëruesi i materialit që përdoret për shumëzim është marrë nga pemëtore mëmë të deklaruar prej tij dhe kontrolluar e aprovuar nga inspektori përkatës i I.K.SH.F.F. dhe i Mbrojtjes së Bimëve (Model. 18).

iii. Të vërtetohet pastertia gjenetike e varietetit nëpërmjet çertifikatës së origjinës (Model. 12).

iv. Të vërtetohet pastertia fitosanitare e materialit mbjellës bimor lëshuar nga Inspektori i Mbrojtjes së Bimëve.

v. Dokumenti nëse është kryer Aprobimi fushor (Model. 9 / 1).

vi. Materiali mbjellës bimor të jetë ambalazhuar në tufa, arka, etj dhe etiketuar për çdo njësi ambalazhimi me etiketën e prodhuesit (Model. 20).

vii. Subjekti prodhues lëshon deklaratën e konformitetit (Model. 2).

b. Proçedurat e çertifikimit

i. Mbështetur në dokumentacionin e mësipërm, subjekti prodhues bën kërkesë pranë Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, që të çertifikohen fidanat.

ii. Mbi bazë të kërkesës, Inspektoret e ngarkuar nga Enti bëjnë verifikimin e dokumentacionit dhe shikojnë në vend kontigjentin e fidanëve, që do të çertifikohet dhe pasi krijojnë bindjen, hartojnë proces—verbalin, “Mbi erifikimin e specifikimeve teknike, dokumentacionit si dhe kontrollin e cilësisë së fidanëve” (Model. 17).

iii. Inspektoret e ngarkuar, mbi bazë të proces-verbalit dhe me dokumentacionin e mësipërm përgatisin Dosjen e çertifikimit.

iv. Mbi bazë të vlerësimit të dosjes Kryeinspektori lëshon çertifikaten e garancise (model. 14), në të cilën shënohet edhe sasia dhe numri i serisë të etiketave zyrtare që i jepen subjektit prodhues.

v. Etiketa Zyrtare ngjitet në çdo njësi ambalazhimi (tufa, arka) dhe jepen në serinë e percaktuar në çertifikatën e garancise. Për fidanet që vine me buke dheu, të jetë i etiketuar çdo fidanë.

vi. Forma, dimensionet, përmbajtja dhe ngjyra e etiketës janë sipas Modelit. 21. Cilësia e Etiketës Zyrtare do të përmbajë elemente sigurie.

vii. Etiketat Zyrtare shoërojnë fidanat, në çdo njësi ambalazhimi, nga prodhuesi në hallkat ndërmjetëse tregtare, deri tek përdoruesi dhe vërtetojnë se materiali mbjellës bimor është i çertifikuar.

viii. Çertifikata e garancisë lëshohet pasi të jetë likujduar tarifa e çertifikimit dhe janë plotësuar dhe tërhequr nga subjekti, sasi të Etiketave Zyrtare.

#### **D. Çertifikimi i fidanave të ardhur nga Importi.**

a. Kërkesat për çertifikimin e fidanave

i. Akt - marrveshja me subjektin e huaj nga importohen fidanat, ku të jenë specifikuar specia, varieteti, kategoria, sasia.

ii. Çertifikata e onigjinës riga shteti importues.

iii. Çertifikata fitosanitare nga shteti importues.

iv. Fidanat të jenë të ambalazhuar dhe të etiketuar ku treguesit e etiketës duhet të korrespondojnë me treguesit e çertifikatës shoqeruese Për fidanet me bukë të jetë etiketuar çdo fidane.

v. Deklaratën e konformitetit për importimin e fidanave (model 2).

vi. Proçes verbalin “Mbi kontrollin e fidanave në pikat doganore dhe lejimit të tij për kryerjen e veprimeve të mëtejshme për çdoganim (Model. 6).

vii. Kërkesa e subjektit për çertifikimin e kontigjentit të fidanave.

b. Proçedurat e çertifikimit.

1. Në bazë të kërkesës se importuesit, Kryeinspektori i farave dhe fidanave bën verifikimin e dokumentacionit dhe kontigjentit të fidanave që do të çertifikohen dhe pasi krijon bindjen harton proçes-verbalin mbi verifikime dhe specifikime teknike, kontrollin e cilësisë dhe dokumentacionin e drufrutorëve (Model. 17).

ii. Personat e ngarkuar mbi bazën e këtij proçes-verbali së bashku me dokumentat e mesipërme përgatisin dosjen e çertifikimit.

iii. Në bazë të vlerësimit të dosjes lëshohet nga Kryeinspektori, çertifikata e garancisë (Model. 14), në të cilën shënohet edhe sasia dhe numri i sense të fishes së kontrollit (Model. 16).

iv. Fisha e kontrollit vendoset në jo me pak se 10% në njësitë e ambalazhimit.

v. Forma, dimensionet dhe përmbajtja e Fishës së Kontrollit janë sipas Model. 16.

vi. Çertifikata lëshohet pasi të jetë likujduar tarifa e çertifikimit dhe janë plotësuar dhe tërhequr sasi të e fishave zyrtare sipas paragrafit të mësipërm.

## **KREU VI TESTIMI I VARIETETEVE**

Neni 22

### **Spektori i Testimit dhe funksionet e tij**

Në Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve funksionon Spektori i Testimit të Varieteteve i cili përgjigjet për:

a. Mbajtjen e regjistrit të aplikimeve.

b. Mbajtjen e plotësimit e vazhdueshëm të Regjistrit Themeltar të specieve dhe varieteteve të bimëve të kultivuara.

- c. Plotësimin e Katalogut Zyrtar të specieve dhe varieteteve të bimëve të kultivuara sipas listës “A” dhe “B” dhe botimi i tij periodikisht.
- d. Mbajtjen e regjistrit për të drejtën e seleksionerit.
- e. Ruajtjen e dosjeve të varieteteve dhe specieve të kualifikuara.
- f. Kryerjen dhe/ose mbikqyrjen e provave zyrtare të testimit të varieteteve të krijuara në vend ose të ardhura nga vende të tjera.

Neni 23

### **Kërkesa për aplikim**

Kërkesa për aplikim për testim të varieteteve paraqitet në Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve. Ajo bëhet në dy kopje sipas dokumentacionit përkatës. Për kulturat pranverore kërkesa dorëzohet brenda 15 Shkurtit, ndërsa për kulturat që mbillen në vjeshte brenda 15 Gushtit.

Në kërkesë duhet të përcaktohet qëllimi i aplikimit për regjistrim në Regjistrin Themeltar të specieve dhe varieteteve të kultivuara dhe në Katalogun Zyrtar.

Neni 24

### **Katalogu Zyrtar**

Katalogu Zyrtar përmban listën “A” dhe listën “B”.

- a. Në listën “A” do të përfshihen të gjitha speciet e varietetet që janë të regjistruar në Katalogun e OECD-së (Organizata për Zhvillim e Kooperim Ekonomik)
- b. Në listën “B” do të përfshihen të gjitha speciet e varietetet që kualifikohen (Koni Shtetëror i Atestirnit të Varieteteve).

Neni 25

### **Testimi i varieteteve**

Testimi i varieteteve përfshin testirnin zyrtar që kryhet nëpërmjet provave fushore, analizave laboratorike dhe elektroforezës.

- a. Testimi zyrtar i varieteteve kryhet në jo më pak se dy vjet për bimët e arave dhe jo më pak se dy vjet pas hyrjes në prodhim per drufrutoret.
- b. Kryerja e testimit zyrtar realizohet në këto zona:
  - për bimët e arave: Shkodër, Tiranë, Lushnjë dhe Korçë.
  - për drufrutorët : Tiranë, Vlorë, Sarandë, Korçë dhe Dibër.
- c. Testimi për dallueshmëri, uniformitet, stabilitet (DUS) kryhet në 1-2 pika për të gjitha varietetet e krijuara në vend dhe për varietetet që nuk është kryer ky test në ndonjë vend tjetër.
- d. Testimi për vlerën e kultivimit e të përdorimit (VCU) kryhet në jo më pak se 3 pika ekologjike për varietetet e krijuara në vend e të huaja si dhe për varietetet regjistruara në Katalogun e OECD kur kerkohet nga të interesuarit.
- e. Kriteret teknike për testet e mësipërme që vleresohen në prova hartohen sipas grup kulturave në përshtatje me kriteret e UPOV-it (Unioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Varieteteve të Reja) dhe miratohen nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.
- f. Sektori i Testimit në bashkëpunim me Institucionet Kërkimore përgatit metodikat e testimit, ndjek e kontroilon zbatimin e tyre dhe përgatit raportin përfundimtar me propozimet përkatëse për Komisionin Shtetëror të Atestimit të Varieteteve (KSHAV).
- g. Gjatë kryerjes së provave është e detyrueshme ruajtja e sekretit, prandaj përdorën vetëm numura në vend të emrave. Kodi i provës mbahet nga drejtori i E.SH.F.F.
- h. Vënia në provë e varieteteve për të cilat kërkohet testimi, kryhet nën përgjegjësinë e sektorit të testimit të varieteteve në E.SH.F.F., kundrejt pagesës sipas tarifave të përcaktuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.

i. K.SH.A.V. me një grup ekspertësh viziton provat, bën vrojtime e vlerësime dhe i paraqet ato në mbledhjen e Komisionit.

#### Neni 26 **Provat zyrtare**

a. Ne zbatim të ligjit Nr. 8732, datë 24.01.2002 “Për materialin mbjellë bimor” aktiviteti i provave zyrtare të testimit të materialit mbjellës bimor organizohet dhe/ose mbikqyret nga Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve.

b. Provat fushore që kryhen në Institucionet Shkençore dhe konkretisht: në Institutin e Kërkimit të Bimëve të Arave (në Stacionet Zonale të tij : Shkodër, Fushkrujë, Lushnje, Korçë, Çerrik), I.P.P, Tirane, UB Tirane, I.K.P.V. Vlorë.

c. Në rastet kur nuk mund të plotësohen kërkesat për ngritjen e provave në Institute, ato mund të kryhen në tokat e fermerëve që do të shihen më të përshtatshme në zonat e percaktuara.

d. Marëdhëniet për detyrimet e ndërsjellta të përcaktohen me një akt- marrveshje të përvitshme.

e. Baza materiale që do të vihet në dispozicion, fuqia punetore që do të shpenzohet dhe interesi i tokës në rastin e fermerëve do të vlerësohet paraprakisht nga te dy palët duke hartuar preventivin përkatës.

f. Testimet për dallueshmëri, uniformitet e stabilitet (DUS) dhe analizat kimike mund të kryhen në E.SH.F.F. ose në institucione të tjera të autorizuara brenda vendit ose jashtë vendit kundrejt pagesës.

g. Likujdimi i shpenzimeve të kryera do të bëhet nga ana e E.SH.E.F. me Urdhër-xhirimi për rastin e Institucioneve Shtetërore në përfundim të provave dhe me lekë në dorë për fermerët në dy faza: në fillim të vendosjes së provës 50 % dhe hkujdim përtiindimtar në fund te provës. Likujdimi i fermerëve do të bëhet duke mbajtur ndërmjet dy palëve.

h. E.SH.F.F. te mbulojë shpenzimet përkatëse për provat me të ardhurat që duhet të vjelë nga aktiviteti i provave të testimit të materialit mbjellës bimor.

#### Neni 27 **Përberja dhe funksionimi i Komisionit Shtetërorë Atestimit të Varieteteve**

a. Pranë Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve funksionon Komisioni Shtetëror i Atestimit të Varieteteve ( K.SH.A.V.). Ky komision ngarkohet me shqyrtimin dhe kualifikimin e varieteteve të reja, që janë produkt i punës përmirësuese gjenetike të Institucioneve publike apo private, të vendit ose të huaja, sipas procedurave të parashikuara në dispozitat ligjore të ligjit “ Për të drejtat e seleksionerit të bimëve”, akteve nënligjore dhe rregullave të perçaktuara në këtë Udhëzim.

b. Komisioni Shtetëror i Atestimit të Varieteteve të reja bimore përbehet si rregull nga 11-15 anëtare, specialistë me përvojë, me njohuri të plota teorike dhe praktike në fushën e përmirësimit gjenetik dhe prodhimit të farave.

c. Çaktimi i anëtarëve të K.SH.A.V, bëhet me propozim të Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve dhe me miratimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit për një periudhë katër vjeçare.

d. Numri i specialistëve në përbërjen e Komisionit që merren direkt me punën përmirësuese gjenetike ose me prodhimin e farave, si rregull nuk duhet të kalojnë 50 % të numrit të përgjithshëm të Komisionit.

e. K.SH.A.V. në mbledhjen e tij të parë, zgjedh me votim të fshehtë Kryetarin dhe Nënkryetarin në një afat katërvjeçar. Sekretar i këtij komisioni emerohet Përgjegjësi i Sektorit të



Testimit të Varieteteve.

f. Kryetari ose në mungesë të tij, nënkryetari dhe Sekretari kanë për detyrë të përgatisin mbledhjen e Komisionit dhe drejtimin e tij. Si rregull, Kryetari ( të ketë titull “Profesor”) dhe Nënkryetari ( të ketë titull “Prof. Asociuar”) në fushën e Punës Përmiruese Gjenetike e të prodhimit të farave.

g. K.SH.A.V. merr vendime me shumice votash, me votim të fshehtë, pas diskutimeve të hapura shkencore, të cilat pasqyrohen në protokollin e Komisionit që mban Sekretari i tij.

h. K.SH.A.V. mblidhet sipas nevojave që dalin për shqyrtimin e varieteteve të reja jo më pak se dy herë në vit. Si rregull, pvr ato pranverore në muajin Mars dhe për ato vjeshtore në muajin Tetor. Mbledhja e Komisionit mund të zhvillohet vetëm kur janë të pranishëm 2/3 anëtarë të Komisionit.

i. Sektori i Testimit të Varieteteve ve në dispozicion të Komisionit pesëmbëdhjete ditë para mbledhjes, gjithë dokumentacionin e procedurës që ka të bëjë me testimin e varieteteve të reja dosjen me të dhënat e provave për dallueshmërinë, uniformitetin e stabilitetin. ( D.U.S.), vetëm me emrin e koduar, pa treguar se kush është Institucioni, Subjekti krijues apo përgjegjës.

j. Komisioni në marrëveshje me Drejtorinë e Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve ka të drejtën e mbikqyrjes se të gjitha hallkave gjatë testimit të varieteteve të reja nëse ato konform rregulloreve përkatëse.

k. Çdo anëtarë i komisionit është i detyruar të ujihet me dosjen e materialeve dhe të përgatisë me shkrim mendimin për çdo varietet të ri që propozohet të kualifikohet ose të rikualifikohet.

Neni 28

### **Shqyrtimi teknik i varietetit nga K.SH.A.V.**

a. Në fillim të mbledhjes Përgjegjësi i Sektorit të Testimit të Varieteteve paraqet rezultatet e Testimit Zyrtar të provave fushore dhe provave të tjera të nevojshme të kryera nga Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve ose nga ndonjë Institucion tjetër për D.U.S ( dallueshmërinë, uniformitetin dhe stabilitetin) dhe për V.C.U. (Vlerën e kultivimit dhe përdorimit) duke dhënë shpjegime për mënyrën e kryerjes së provave të shoqëruara me relacionin përkatës. Krahas relacionit duhet të ekspozohen edhe kampione bimësh e kallinj të varieteteve të reja birnore me numra. Emërtimi i propozuar mbahet i fshehtë nga Drejtori i E.SH.F.F., sipas numrit përkatës të shënuar në regjistrin e provave.

b. Bëhen pyetje dhe diskutime nga anëtarët e Komisionit rreth materialeve të paraqitura dhe për çështjet e paqarta apoë pasigurta kërkohet mendimi i eksperteve të paanshëm.

c. Pas diskutimit bëhet votimi për çdo varietet, në bazë të të cilit merret vendimi përkatës.

d. Të gjitha varietetet që në provat e testimit nuk kanë siguruar treguesit për dallueshmërinë, uniformitetin, stabilitetin (D.U.S.) përjashtohen paraprakisht dhe nuk merren në konsideratë.

e. Të gjitha varietetet që në provat e testimit nuk kanë arritur nivelin e treguesve për vlerën e kultivimit dhe përdorimit (V.Ë.U.) të varieteteve që janë aktualisht në strukturën e mbjelljes, nuk bëhet kualifikimi, me përjashtim kur ata kanë vlera të veçanta në kultivim dhe përdorim.

f. Pas votimit, Kryetari, Nënkryetari dhe Sekretari formulojnë vendimin përkatës, një kopje të cilit i jepet për zbatim E.SH.F.F. dhe një kopje i dërgohet Drejtorisë së Shkencës në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit.

g. K.SH.A.V. është i detyruar të ruaj sekretin dhe fshehtësinë e varieteteve që merren në shqyrtim, lidhur me rrugën e krijimit dhe vlerën e tyre.

h. K.SH.A.V. jep të drejtën e seleksionerit dhe patentën e varietetit, e cila shpallet me urdhër të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit brenda 30 ditëve nga dhënia e kësaj të drejte.

i. Vendimi i marre nga K.SH.A.V. i behet e ditur palës aplikuese brenda 5 ditëve. Kundër

vendimit të K.Sh.A.V., brenda 10 ditëve nga shpallja, bëhet ankim ne bordin e apelit pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

j. Puna që kryhet nga K.SH.A.V. paguhet sipas Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr.254, datë 18.05.2001.

Neni 29

### **Bordi i Apelimit të Atestimit të Varieteteve**

a. Në zbatim të nenit 16, pika 3, të ligjit nr.8880, datë.15.04.2002, “Për të drejtat e seleksionerit të bimëve”, pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit funksionon Bordi i Apelimit ndaj vendimeve të KSHAV.

b. Ky Bord përbehet nga pesë anëtarë. Njeri është Ministër ose Zv.Ministër i Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe drejton këtë bord. Ky bord çaktohet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit.

c. Detyrat kryesore të Bordit janë:

i. Të regjistrojë çdo ankesë që bëhet ndaj KSHAV për të drejtën e seleksionerit.

ii. Të grumbullojë materialet dokumentare për vlerësimin e varietetit dhe dokumentet e KSHAV.

iii. Të shqyrtojë dokumentet brenda 90 ditëve nga data e paraqitjes së ankesës.

iv. Të jepet përgjigje me shkrim brenda 5 ditëve nga dita e marrjes së vendimit nga ana e Bordit të Apelimit.

. E.SH.F.F. të botojë rregullisht vendimet e Bordit të Apelimit në buletin e tij.

d. Bordi mblidhet sipas ankesave të paraqitura por jo më rrallë se një herë në 3 muaj kur ka ankesa.

e. Vendimet e Bordit merren me shumicë votash dhe kur marrin pjesë mbi 3 vetë dhe ato zbatohen nga E.SH.F.F..

f. Kundër Vendimit të Bordit të Apelimit bëhet ankim në gjykatë brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit për vendimin.

## **KREU VII**

### **ORGANIZIMI I SISTEMIT TE RUAJTJES DHE TRAJTIMIT TË RESURSEVE GJENETIKE TË BIMËVE DHE FUNKSIONIMI I BANKËS GJENETIKE**

Neni 30

#### **Klasifikimi i resurseve gjenetike**

Klasifikimi i resurseve gjenetike bimore për ruajtje (Material mbjeliës gjenetik)

Resurset gjenetikë bimore klasifikohen si vijon:

a. kultivarë;

b. kultivarë primitivë dhe popullata vendi;

c. linja, linja inbrede;

d. mutante;

e. specie të egra;

f. klone (rrënjë, zhardhokë).

Neni 31

#### **Sistemi i ruajtjes dhe trajtimit të resurseve gjenetike bimore.**

Për veprimtarinë shkencore të resurseve gjenetikë të bimëve organizohet “Sistemi i ruajtjes dhe trajtimit të resurseve gjenetike të bimëve”,

Në të përfshihen

- a. Banka Gjenetike.
- b. Koleksionet ku ruhet germoplazma e bimëve të arave, drurëve frutore, florikulturës, bimëve dekorative, bimëve pyjore etj., në zotërim të instituëioneve shkencore.
- c. Zonat e mbrojtura ose rezervatet “in-situ”, ku janë përhapur e rritur në mënyrë natyrore, fara spontane ose të egra të resurseve gjenetike të bimëve. Këto mund të jenë në zotërim të Bankës Gjenetike, të instituëioneve shkencore ose në pronësi private.
- d. Koleksione bimore private të zotëruara nga persona private, bashkësi fshatare ose grup prodhuesish.
- e. Kopshtet botanike në zotërim të Instituëioneve publike dhe private.
- f. Koleksionet dhe zonat e mbrojtura sipas pikave a dhe b të nenit 30, me propozim të Bankës Gjenetike dhe në raste të veçanta ato sipas pikës c, të nenit 30, përçaktohen e finançohen nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, drejtpërdrejt ose nëpërmjet Bankës Gjenetike, apo Instituëioneve Shkenëor.

#### Neni 32

### **Banka Gjenetike kuptimi i saj**

Banka Gjenetike, që funksionon pranë Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, është institucion i mirefilltë shkençor me rëndësi kombëtare, i cili grumbullon dhe ruan fondin gjenetik bimor të një vendi.

#### Neni 33

### **Përbërja dhe funksionet e Këshillit Kordinativ**

- a. Në Institucionin e Bankës Gjenetike, funksionon Këshilli Kordinativ (me 11-13 veta), i cili mblidhet të paktën 1 herë në 2 muaj.
- b. Në përbërjen e Këshillit Kordinativ marrin pjesë : specialistë të Bankës Gjenetike, specialistë të kesaj fushe nga Institucionet Shkencore dhe Arsimore të vendit.
- c. Anëtarët e Këshillit Kordinativ miratohen nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit, me propozim të Bankës Gjenetike dhe me pëlqimin e drejtuesve të instituëioneve përkatëse.
- d. Anëtarët e këtij Këshilli do të jenë edhe bashkëpunetore të punës ndërmjet Bankës Gjenetike dhe këtyre instituëioneve.

#### Neni 34

### **Funksionet dhe detyrat e Bankës Gjenetike**

Institucioni i Bankës Gjenetike ka keto funksione e detyra:

- a. Organizon grumbullimin dhe koleksionimin e germoplazmës bimore të vendit me anë të ekspeditave apo rrugëve të tjera. Ajo mund ti organizojë vetëm dhe së bashku me institucionet e tjera të vendit ose të huaja.
- b. Merr në ruajtje germoplazmën që i përket “koleksionit bazë” dhe “koleksionit aktiv” të instituëioneve kërkimore-shkencore dhe kur ka mundësi, me kërkesë të instituëioneve përkatës, merr në ruajtje edhe pjesë të “koleksionit të punës” të këtyre instituëioneve.
- c. Merr në ruajtje materialin bimor të shoqëruar me dokumentacionin përkatës (kompjuterizuar) sipas rregullave dhe standarteve ndërkombëtare për ruajtjen në Bankë (standartet e IPGRI-t - Instituti Ndërkombëtar i Resurseve Gjenetike Bimore).  
Dokumentacioni shoqëruar përmban:
  - Te dhënat identifikuese të materialit bimor (të dhënat e pasaportës);
  - Të dhënat e karakterizimit;
  - Të dhënat e koleksionit.
- d. Materiali bimor merret në ruajtje mbi bazën edhe të një proces — verbali të nënshkruar

nga të dyja palët.

e. Ruan germoplazmën e koleksionuar sipas rastit apo formave të ruajtjes, me afat të shkurtër, të mesëm dhe të gjatë.

f. Germoplazma mund të ruhet në formë ‘ex-situ’ (farëza, zhardhokë, rrënjë, pjesë vegjetative), ‘in-vivo’ (koleksione fushore) dhe ‘in-vitro’.

g. Studion, karakterizon dhe vlerëson materialin e koleksionuar për treguesit morfologjike, gjenetike, biologjike, kimikë dhe agrokimike në bashkëpunim me institucionet kërkimore të vendit.

h. Shumëzon dhe përtërin materialin bimor të koleksionuar në bazë të monitorimit të koleksioneve apo në rast nevojë nga institucionet kërkimore shkencore.

i. Shumëzimi i materialit bimor si në rastet kur kryhet në koleksionet e institutivë kërkimore apo dhe tek privati, realizohet mbi bazën e një akt-marrëveshjeje të ndëshkuar nga të dyja palët.

j. Organizon evidentimin, informatizimin dhe publikimin e të dhënave (banka e të dhënave) për resurset gjenetike që disponon.

k. Organizon në bashkëpunim me institucionet kërkimore shkencore përpilimin e inventarit kombëtar të resurseve gjenetike bimore që ruhen në koleksione.

l. Organizon këmbimin falas të materialit bimor (fare) dhe të informacionit, me institucione të tjera shkenëore homologe brenda dhe jashtë vendit për aktivitete shkencore apo për sigurimin dhe ruajtjen më të plotë të materialit bimor (ruajtja në dublikate e materialit në banka të tjera homologe).

m. Për problemet metodike dhe veprimtarite shkencore të resurseve gjenetike të bimëve, Banka Gjenetike kryen rolin e kordinatorit me institucionet e tjera shkenëore të vendit që kryejnë veprimtari në këtë fushë.

n. Harton dhe kordinon projekte apo merr pjesë në programe punë të përbashkëta në nivel rajonal për problemet e ruajtjes së resurseve gjenetike bimore.

o. Mban lidhje dhe bashkëpunon me IPGRI-in dhe institucioneve të tjera homologe jashtë vendit.

Neni 35

Zonat e mbrojtura (Rezerva ose ruajtja “in situ”)

I. Për qëllimin e ruajtjes nga erozioni gjenetik të materialit gjenetik bimor me vlera të veçanta, që rritet lirisht në naryrë, organizohet ruajtja “in-situ” e germoplazmës së zonave të caktuara, të cilat merren nën mbrojtjen shtetërore.

II. Si zona të mbrojtura (rezervate ose ruajtja in-situ) caktohen ato zona ku zhvillohen bimë autoktone spontane që kanë lidhje fare bimore me bimët e kultivuara, birnët e egra me vlera të veçanta, por që rrezikohen të zhduken etj.

Zonat e mbrojtura percaktohen me vendim të përbashkët të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Komitetit të Mbrojtjes së Mjedisit.

Me të njëjtin vendim për këto zona percaktohen masa të veçanta, si: moskullojtja, moskositja, mbrojtja nga zjarri etj.

III. Institucionet e organizmat që ngarkohen të zbatojnë masat e mbrojtjes të materialit gjenetik bimor, janë

a. Drejtoria e Prodhimit Bimor dhe Drejtoria e Shkencës dhe kualifikimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit.

b. Banka Gjenetike.

c. Institutet Kërkimore Shkencore për bimët që ato mbulojnë.

d. Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve.

e. Në rreth, Drejtoritë e Bujqësisë dhe Ushqimit, Drejtoritë e Pyjeve dhe Drejtoritë e Kullotave.

KREU VIII  
AMBALLAZHIMI, RUAJTJA DHE ETIKETIMI I MATERIALIT MBJELLËS BIMOR

Neni 36

**Kërkesa të përgjithshme**

a. Të gjitha prodhimet e realizuara për përdorim si material mbjellës bimor, tregtohen pasi të jenë përpunuar, pastruar, homogjenizuar dhe kalibruar në tote, sipas kërkesave dhe kushteve teknike.

b. Subjektet prodhuese dhe tregtuese të materiatit mbjellës bimor duhet të disponojë dhe të përdorin, magazinat, pika shitje dhe mjedise të përshtatshme gjatë përpunimit, amballazhimit, ruajtjes dhe tregtimit të tij, duke siguruar ruajtjen e treguesve cilësor sipas parametrave teknike për çdo materiat mbjellës bimor.

c. Subjektet prodhuese dhe tregtuese të materiatit mbjellës bimor që nuk disponojnë impiante dhe pajisje për pastrim, homogjenizim, kalibrim, dizinfektim u tejohe, që këto procese ti kryejnë në ambjente të subjekteve që i disponojnë ato, te licensuara për prodhimin dhe shumëzimin e farave me kusht që të rregjistrohen veças për çdo subjekt.

Neni 37

**Amballazhimi**

Të gjitha farat e përpunuara ruhen dhe tregtohen të amballazhuara. Për amballazhim përdoren thasë e qese beze, tetre, zarfa tetre, kuti kartoni, llamarinë, etj. Zhardhokët, bulbat, rizomat, etj. amballazhohen në çastin e tregtimit.

Mbyllja e amballazhit duhet të jetë e tillë që të jetë e pamundur hapja e tyre pa lënë gjurmë.

a. Farat e drithrave, foragjerëve, bishtajore, bimëve vajore, eterovajore industriale amballazhohen në thase 5 — 50 kg. Fara e grunt dhe e misnit duhet te disifektohet për kontigjentet që këtë hidhen në shitje.

b. Farat e imta të perimeve, luleve, amballazhohen në zarfa ose qeska te caktuara sipas llojit të farës.

c. Patatet, hudhrat dhe qepujkat amballazhohen në thasë rrjetë ose arka më peshë 25 kg, Hudhrat në thasë lidhen në vargje, ndërsa kur amballazhohen në arka, tejohe çdo kokërr hudhre të ketë bishtin den 2 cm të gjatë.

Neni 38

**Ruajtja e materialit mbjellës bimor.**

a. Vendosja e farave bëhet në depo ose magazina, të pastra, të ajrosura, me lagështi optimale sipas kërkesave specifike të çdo specie, të disinfektuara, të ndara për çdo lot.

b. Thasët vendosen 10 — 15 cm (në paleta) mbi sipërfaqen e tokës dhe 40 cm larg nga faqja e murit. Ato vendosen në paleta, njëri mbi tjetrin 8 — 10 cope. Ndërsa fara e hapur (rifuxhio) e grunt, thekrës, elbit vendoset 1 — 1.5 m lartësi, misri vendoset 0.5 — 1 m lartësi dhe orizi vendoset 30 cm lartësi.

c. Fidanat frutore në të cilat përfshihen fidana : mollë, dardhë, ftoj, kumbull, qershi, pjeshke, kajsi, mushmolla, nespulla, arra, bajame, lajthi, kaki, fiku, shega, geshtenja, mani, etj. Kushtet për seëilën ëilësi janë

i. Fidanat frutore të cilësisë së parë lidhen në tufa me nga 10 copë secila.

ii. Fidanat frutore të cilësisë së dytë lidhet në tufa me nga 20 cope secila.

iii. Rrënjët e fidanave në tufë vendosen në kashtë, bar, tallash, myshk pylli ose materiale

të tjera mbështjellës. Kur fidanat do të transportohen në distanca të afërta ambalazhimi bëhet me kashtë në mjetet e transportit.

iv. Tufat e fidanëve renditen në karroceri ku fundi dhe anët e mjetit shtrohen me 20 cm kashtë. Kashta vendoset edhe midis rreshtave. KarrocERIA mbulohet me mushama ose plasmë.

d. Fidanat e ullirit, agrumeve, nespulles, etj. që nuk rrezojnë gjethet, shkullen me bukë dhe me peshë 4-6 kg dhe ambalazhohen një për një në qese plasmë. Ato transportohen duke e mbuluar karrocERIN me mushama ose plasmë.

e. Fidanat e hardhise lidhen në tufa me nga 25 cope, ose në kuti kartoni me 25 -50 cope në çdo kuti.

f. Në çdo tufë të fidanave frutore dhe të hardhive dhe në çdo fidanë ulliri, agrume, etj. që janë me bukë dhe vendoset etiketa e prodhuesit dhe etiketa zyrtare.

g. Transportimi i fidanave frutore nuk bëhet kur fryn ere dhe temperatura është nën 0 °C.

h. Fidanat frutore të shkullur ruhen deri në momentin e transportit ose të mbjelljes, të shtratifikuar në tokë, në rrë, në depo, hangar dhe vendet e mbrojtur nga ngricat e demtimet. Shtratifikimi i fidanave është specifikim teknik edhe gjatë periudhës së shitjes.

i. Për verifikimin e kërkesave cilësore të fidanave duhet të kihet parasysh që partia përfaqëson një sasi me tregues të njëjtë fidanash, të përgatitur për tregtim nga prodhuesi, çdo parti fidanash frutore duhet të plotësojë kërkesat e kushteve teknike të kategorisë përkatëse bashkëgjatë këtij udhëzimi.

j. Për percaktimin e cilesise të cdo partie në vende të ndryshme merren mostra si rregull Jo më pak se tre tufa të cilat vlerësohen sipas treguesve të kushteve teknike.

#### Neni 39

#### **Etiketimi, permbajtja e etiketës dhe llojet e etiketave që përdoren, fishet e kontrollit.**

Materiali mbjellës bimor i vlefshëm për tregtim shoqërohet detyrimisht me dy lloj etiketa

a. Etiketa e prodhuesit, vihet nga prodhuesi në ambalazh ose fidanë, në të cilën deklarohen treguesit cilësorë.

b. Etiketa zyrtare përgatitet dhe hidhet në qarkullim nga Enti Shtetërorë i Farave dhe Fidanëve. Ajo vendoset në ambalazh ose në fidanë. Kjo etiketë vërteton se loti ose partia është certifikuar dhe kontrolluar nga organet zyrtare.

a/1. Etiketa e prodhuesit përmban

- Emri i subjektit,
- Numri i licensës ose kodi fiskal,
- Specia,
- Kultivari,
- Kategoria,
- Prejardhja ( vendi i orodhimit)
- Prodhuesi,
- Fuqia mbirëse,
- Data e analizës,
- Pastërtia varietore,
- Pastërtia mekanike,
- Trajtimi (Emri I pesticidit ose lëndës kimike për peletim),
- Sasia e materialit mbjellës.

a/2. Për fidanat frutorë specifikohet emri i nënshartesës. Nuk shënohet fuqia mbirëse, data e analizës, pastërtia varietore dhe mekanike.

Fuqia mbirëse nuk shënohet edhe për tuberet, zhardhokët, bulbat dhe rizomat. Treguesit e fuqisë mbirëse rianalizohen çdo gjashtë muaj.

Për farat e përzjera në etiketë shënohet përqindja që zë çdo specie apo kultivar në ambalazh.

Kur materiali mbjellës bimor është trajtuar kimikisht, detyrimisht në etiketë shënohet (i pakonsumueshem nga njerëzit dhe kafshët).

Në raste të veçanta në etiketë mund të vendosen të dhëna shtesë që lidhen me kushtet e ruajtjes dhe afatin e përdorimit.

b/1. Etiketa zyrtare e farave ka këto karakteristika dhe përmbajtje Karakteristikat

- Forma drejtkëndëshe,
- Ngyra për secilën kategori të materialit mbjellës bimor janë
- E bardhë me vija diagonale violet për kategorinë P/BAZE (superelite).
- E bardhë ër kategorinë BAZE (elite).
- Blu për kategorinë e ÇERTIFIKUAR (riprodhimi i parë dhe F1 dhe i dytë)
- Portokalli për kategorinë TREGTARE
- Gri për farat e përzjera (ku shënohet dhe riprodhimi).
- Të dhënat shtypen në një anë të etiketës. Materiali i etiketës duhet të jete i qëndrueshem ndaj dëmtimeve të ndryshme dhe lageshtisë.

Përmbajtja

- Emrin e Institucionit që e lëshon ( E.SH.F.F.)
- Numri i sense.
- Specia ( në gjuhën shqipe dhe latine)
- Varieteti ( ose Kultivari)
- Kategoria.
- Subjekti prodhues
- Vendi i prodhimit.
- Peshë neto.
- Data

b/2. Etiketat zyrtare për materialin mbjellës bimor të drufrutorëve ka këto karakteristika dhe përmbajtje.

Karakteristika

- ka formën drejtkëndëshe me përmasa 17 x 5 cm,
- e bardhë.

Përmbajtja

- Emri i Institucionit që e lëshon (E.SH.F.F.)
- Numri i sense.
- Specia ( në gjuhën shqipe dhe latine)
- Varieteti ( ose Kultivari)
- Nënshartesa
- Kategoria.
- Vendi i prodhimit.
- Prodhuesi.
- Sasia.
- Data.
- Nr. i certifikimit

Çdo kontigjent i materialit mbjellës bimor për tregtim, krahas etiketës së prodhuesit dhe etiketës zyrtare duhet të jetë i shoqëruar edhe me certifikatën e garancisë. Numri i sense së etiketës zyrtare të vendosur në amballazh, duhet të përputhet me numrin e sense së pasqyruar në certifikatën e garancisë.

- Riamballazhimi i materialit mbjellës bimor kur është e nevojshme, bëhet në prani të përfaqësuesve të organeve të kontrollit.

- Prodhuesi mban përgjegjësi për mospërputhje të treguesve cilësorë të deklaruar në etiketën e tij edhe pas vendosjes të etiketës zyrtare.

- Ndalohet mbajtja në mjediset e shitjes dhe të magazinave të materialit mbjellës bimor të prodhimeve të njëjta të paamballazhuara, të paetiketuara dhe që nuk janë caktuar për këtë qëllim.

c. Fishet zyrtare të kontrollit vërtetojnë se materiali mbjellës bimor i ardhur nga importi i është nënshtruar kontrollit të I.K.SH.F.F. dhe është lejuar të përdoret si material mbjellës bimor në territorin e Republikës së Shqipërisë.

c/i- Fishet e kontrollit për fare të importuar kanë këto karakteristika dhe përmbajtje.

Karakteristika

- ekuqe.

Përmbajtja

- Emni i institucionit që lëshon

- Specia

- Numri serial

- Kontrolluar

c/2. Fishet e kontrollit për fidana të importuara kanë këto karakteristika dhe përmbajtje.

Karakteristika

- jeshile.

Përmbajtja

- Emri i Institucionit që lëshon

- Specia

- Numri serial

- Kontrolluar

ç. Etiketat zyrtare dhe fishet e kontrollit, janë prone e E.SH.F.F. dhe hidhen në qarkullim vetëm prej tij. Ato kanë elemente sigurie dhe numër serial.

## KREU IX

### PRO E MARRJES DHE LËVIZJES SE MOSTRAVE PËR ANALIZA ZYRTARE

#### Neni 40

#### **Procedurat e marrjes së mostrave**

1. Loti i farës — (kontigjent, parti fare, ngarkesë) është sasia e farës e homogjenizuar e të njëjtit lloj, kulture, riprodhimi, me veti cilësore uniforme.

Per çdo lloj, sasi të lotëve, për efekt mostrimi, janë sipas tabelës Nr. A.

2. Mostër primare — është sasia e farës e marrë nga një pike në lotin e farës.

3. Mostra e përbërë — formohet nga kombinimi dhe përzjerja e të gjitha mostrave primare të marra nga loti i farës.

4. Mostra mesatare (nenmostra) — është sasia e farës që përftohet nga zvogëlimi i mostrës së përbërë nga e cila merren mostra për laboratorin e testimi të farës. Madhësia e saj përcaktohet në tabelën Nr. A

5. Mostra e punës - është mostra që formohet në laborator për të bërë një ose disa teste tëfarës.

A. Pajisjet për marrjen e mostrave

a. Për farat që rrjedhin shpejt (jonxha, etj.) përdoret sonda me 6 dhoma.

b. Për farat që lëvizin me ngadalë (loliumi) përdoret mar me dorë, në disa vende të ndryshme.

c. Për farat rifuxhio përdoret sonda me vakum ose automatike.

B. Marja e mostrës primare.

a. Të drejtën e marrjes së mostrës për provat zyrtare të farave e kanë Inspektoret e Inspektoriatit të Kontrollit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve në qendër e në rrethe, si dhe personat e autorizuar.

b. Mostra merret me dorë ose me sonde sipas mundësisë dhe rastit.

c. Kur fara është e ambalazhuar në thasë, mostra merret duke shpuar thasët me sondë në vende të ndryshme të stives (lart, mes dhe fund)



- d. Numri i mostrave primare që merret nga loti i një fare, duhet të jetë
- i. Deri në 500 kg fare, merren 5 mostra primare. Për 1 thes 50 kg. futet 5 herë sonda, 2 diagonale dhe 3 vertikale.
  - ii. Nga 501-3000 kg, merret 1 mostër primare për çdo 300 kg.fare, por jo me pak se 5 mostra primare (sonda).
  - iii. Nga 3001-20.000 kg, merret 1 mostër primare për çdo 500 kg. fare, por jo më pak se 10 mostra primare (sonda).
  - iv. Nga mbi 20.000 kg. merret 1 mostër primare për çdo 700 kg fare, por jo me pak se 40 mostra primare (sonda).
- e. Kur farat ruhen në paketa, për një parti deri në 1.000 paketa, mostra primare merret ne 1 % të paketave, kur ato kane një numër reference.
- f. Kur farat ruhen në paketa, bustina, enë aluminante cilindrike, per çdo lloj fare, për çdo varietet të të njëjtit lloj fare, merret mostër primare sipas madhësisë të percaktuar në tabelen “Pesha minimale e mostres së farës”, që i bashkëngjitet këtij Udhëzimi.
- Dorëzimi i mostres në Laborator.
- a. Mostra e farës për analize zyrtare merren nga Inspektoret në qendër ose në rrethe dhe i dorëzohen punonjësit të ngarkuar në Ent për pranimit të mostrave. Pasi regjistrohet në Regjistrin e pranimit të mostrave, dorëzohet laboratorit duke ruajtur sekretin e emrit të subjektit.
  - b. Mostra për Laborator ambalazhohet në materiale te tilla që nuk ndikojnë në ndryshimin e treguesve cilesore të mostres.
  - c. Mostra për Laborator që destinohet për percaktimin e lageshtisë, vihet në enë qelqi, të pastra e të thata, të mbylura me tapë dhe të dyllitura. Nga jashtë i vihet etiketa.
  - d. Mostra e farës për Laborator është e ambalazhuar në material prej letre ose plastike. e miratuar nga E.SH.F.F., e mbushur den 2/3 e volumit të saj, e mbyllur dhe e vulosur nga inspektori që e ka marrë atë.
  - e. Mostrës së farës për Laborator të ambalazhuar, i vihet brenda etiketa përkatëse.
  - f. Mostrat e fares qe dorezohen ne Laborator kodohen nga analisti i ngarkuar per pranimin e tyre, me qëllim që të mos identifikohet subjekti prodhues dhe tregues i farës.
  - g. Mostrat e farvs që dorëzohen në laborator, pranohen kur ato janë të rregullta në ambalazh, masë, dokumentacion, mbyllje dhe kur paraqiten brenda 24 orëve. Mostrat e parregullta nuk pranohen.
  - h. Madhesia e Lotit të farës dhe Pesha minirnale e mostrës të marrë nga Loti tabelave bashkëngjitur Udhëzimit.

## KREU X LABORATORI QENDROR I TESTIMIT TE FARAVE

### Neni 41

#### **Detyrat dhe funksionet e Laboratorit**

- a. Në E.SH.F.F. funksionon Laboratori Qendror i Testimit të Farave (L.Q.T.F.), i cili në bazë të ligjit “Për materialin mbjellës bimor”, Nr. 8732, datë 24.01.2001, është i ngarkuar të kryejë Analizë Zytare.
  - b. Laboratori Qendror i Testimit të Farave, mbi bazën e analizave që kryen është organi që lëshon Fletë Analizën e rezultateve të lotit të farës (Modei.3). Kjo Fletë Analizë ka vlerë zyrtare për efekt certifikimi të lotit, kur materiali mbjellës bimor përdoret brenda vendit.
- Ndërsa kur materiali mbjellës bimor përdoret për eksport, Laboratori lëshon certifikaten Ndërkombëtare të Lotit të Fares (Model. 3/1)
- c. L.Q.T.F. aktivitetin e tij dhe kryerjen e analizave e bazon në
    - i. Në Legjisiacionin shqiptar në fuqi (Ligje, vendime, akte-nënligjore, udhëzime të Ministrit).

ii. Në specifikimet teknike (standarte) të vendit të percaktuara në këtë udhëzim (Tabela N.1).

iii. Për analizat që kryen, zbatohen metodikat e testimit sipas rregullave të I.S.T.A.-s, të percaktuara në manualin e testimit të farave të depozituar në E.SH.F.F.

iv. L.Q.T.F. si i zgjedhuri i Ministrisë të Bujqësisë dhe Ushqimit për akreditimin në ISTA, përmbush me korektësi të gjitha detyrimet që rrjedhin nga akreditimi në këtë Organizem.

v. L.Q.T.F. zbaton me rigorozitet metodikat për nxjerrjen e rezultateve. Me dhënjën e rezultateve nuk influenëohet nga ndikimet dhe per saktësinë e tyre, në rast kontestimit mban përgjegjesi për pasojat që sjell.

vi. Për të eliminuar ndikimet komerciale dhe financiare të subjekteve të ndryshme, në rezultatet e analizave në të gjitha rastet futja e mostrave për analizë zyrtare të bëhet me kod.

vii. L.Q.T.F. përveç analizave zyrtare bën edhe analiza private.

d. Përveç Laboratorit L.Q.T.F., analiza për treguesit cilësor të farave kryhen edhe në laboratorët e tjera publike e private, të cilët shërbejnë subjekteve por Jo si analiza zyrtare për certifikim.

## KREU XI DISPOZITAT E FUNDIT

### Neni 42

#### **Detyrimet financiare**

Për shërbimet që kryen E.Sh.F.F., Analizat Laboratorike, Testimi Varietor, Regjistrimi Zyrtar i kuitivarëve, Aprobimin dhe certifikimin e Materialit Mbjellës Bimor, subjektet do të paguajnë pranë E.Sh.F.F. sipas tarifave të percaktuara në udhërin e veçantë të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

### Neni 43

Ky udhëzim hyn ne fuqi menjëherë.

**MINISTRI**  
**Agron Duka**

**KËRKESË**

**Për pajisjen me leje për prodhimin e riprodhimin e materialit  
mbjellës bimor**

*ENTIT SHTETËROR*

*TË FARAVE DHE F/DANËVE*

Unë, nënshkruari....., fermer (subjekt fizik ose juridik) nga rrethi  
....., Komuria....., Fshati....., në zbatim të Ligjit Nr.  
8732, dt. 24.01 .2001 dhe Vendimittë K.M. Nr.155, germa d, kërkoj të pajisem me leje.

Unë do të prodhojë këto materiale mbjellës bimorë:

1. ....
2. ....
3. ....

Për këtë disponoj, ..... ha tokë prone ose me qera, disponoj makineri përpunimi në  
pronë ose me qera, disponoj ambiente për përpunimin e materialit mbjellës bimorë në pronë.....  
m<sup>2</sup>, për të prodhuar....., copë fidanë,..... kv fare ose me qera..... m<sup>2</sup>, për të  
prodhuar..... cope fidanë,..... Kv farë.

Drejtimi teknik do të bëhet nga unë si speçialist lartë ose do te angazhojë  
z..... specialist i lartë

Bashkangjitur, me kërkesën p0 ju dergojë dokumentaëionin e nevojshëm sipas ligjit dhe  
urdhërit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

Shpresoj që kërkesa ime të miratohet nga ana Juaj.

**KËRKUESI**

(.....)

**DEKLARATE KONFIRMITETI**

Unë, nenshkruari z....., me licencë  
nr..... datë  
....., kod fiskal nr..... datë....., me  
adresë  
....., sot me datë..... deklaroj nën  
përgjegjësinë time personale se materiali mbjellës bimor.....  
prodhuar / importuar nga ana me është konform këtij specifikimi teknik:  
1. Është shoqëruar me çertifikatën e origjines nr. .... datë.....  
2. Është i shoqëruar me çertifikatën fitosanitare nr. .... date.....  
3. është i shoqëruar me rezultatin e analizës nr. .... date.....  
4. Kultivari, hibrid, varieteti.....  
5. Mbishartesa.....  
6. Nënshartesa .....  
7. Cilësia.....  
8. Është i ambalazhuar në....., me peshë.....  
Numri i kokrrave.....  
9. Është i etiketuar me etiketa të lëshuara  
nga..... dhe i përket lotiti nr.  
.....

Lëshoj këtë deklaratë konfirmiteti konform Ligjit Nr.8732, datë 24.1.2001, “Për materialin mbjellës bimor”, nenit 11, pika ‘b’ dhe mbaj përgjegjësi për vërtetësinë e specifikimeve teknike të bëra në këtë deklaratë.

DEKLARUESI

(.....)

.....më  
datë.....

**ENTI SHTETEROR I FARAVE DHE FIDANEVE**

**ETIKETË  
MARRJE KAMPIONESH**

Nr....., date.....

Emri i subjektit .....

Kultura.....

Varieteti.....

Riprodhim.....

Viti i prodhimit.....

Kontigjenti nr. (Loti).....

Pesha e kontigjentit kv.....

Nr. vendeve nga merret kampioni.....

Analiza që do ti bëhet farës.....

Nr. Lotit.....

**ENTI SHETETEROR I FARAVE DHE FIDANEVE INSPEKTORIATI I KONTROLLIT  
SHETETEROR I FARAVE DHE FIDANEVE**

ÇERTIFIKATE E GARANÇIE PER MATERIALIN MBJELLË S BIMOR TË PRODHUAR NË  
VEND (NR DATË.....)

Ne mbështetje të ligjit “Per materialin mbjellës bimor” dhe Vendimeve të Këshilut të Ministrave, Nr.154, date 25.04.2002, Nr.156, date 25.04.2002, Nr.157, date 25.04.2002, Inspektorati Kontroflit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, pasi administroj dokumentaëionin teknik të perëaktuar në V.K.M., Nr.156, date 25.04.2002 dhe e vlerësoj ate te rregullt, lëshon këtë çertifikate garanëie per M.M.B. té prodhuar në vend, me të ëi konfirmon:

Loti i fares i meposhtem është prodhuar nga subjekti....., sipas proëedurave teknike të përëaktuara në V.K.M., Nr.156, date 25.04.2002, është etiketuar me etiketën zyrtare të lëshuar nga E.Sh.F.F. dhe ka të dhënat që vijon:

Specia :.....  
 Varieteti :.....  
 Kategoria :.....  
 Numri references :.....  
 Pesha e lotit :.....  
 Lioji i njësisë së ambaflazhimit :.....  
 Pesha e njesise së ambaUazhimit :.....  
 Nr. Sense te Etiketës Zyrtare :.....  
 Ngjyra e Etiketës Zyrtare :.....

**KRYEINSPEKTORI**

Tiranë, më.....

**REPUBLJKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E BUJQËSISË DHE USHQIMIT**  
**ENTI SHTETËROR FARAVE DHE FIDANËVE**  
**INSPEKTORIATI I KONTROLLIT SHTETËROR TË FARAVE DHE**  
**FIDANËVE**

**PROVES VERBAL**

**Mbi kontrollin e materialit mbjelles bimor në pikat e kalimit të kufirit dhe lejimit të tij per kalim tranzit në doganat pritëse**

Sot, më datën..... (.....),  
ditën ....., ora ..... ne pikën e kalimit  
kufitar..... nga mua z. .... Inspektor Shërbimit të Mbrojtjes së  
Bimëve (karantinës), ne piker doganore të ....., në zbatim të Urdhërit  
Nr.333, dt. 26.07.2002, të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, jam ngarkuar dhe përgjigjem per  
kontrollin e procedurave të importit dhe eksportit të materialit mbjelles bimor, konfirmoj se kam  
kryer kontrollin fizik dhe dokumentaëionin shoqerues të materialit mbjelles bimor si me poshte:

1. Materiali mbjelles bimor (fara ose fidana) \_\_\_\_\_
2. Varieteti \_\_\_\_\_
3. Riprodhimi \_\_\_\_\_
4. Klasa \_\_\_\_\_
5. Sasia (ton, kv, kg, ëope etj.).
6. Poseduesi i mallit (subjekti importues).
7. Transportues i mallit \_\_\_\_\_ (subjekti transportues).
8. Tipi i mjetit dhe targa
9. Dogana pritëse që do të bëjë çdoganimin e mallit \_\_\_\_\_

Konstatova:

A. Materiali mbjelles bimor është (nuk është) shoqeruar me dokumentaëionin e plote teknik sipas kërkesave të ligjit Nr.8732, dt.24.01 .2001, “Per materialin mbjelles bimor”.

Disponon këto dokumenta:

1. Çertifikatën fitosanitare \_\_\_\_\_
2. Çertifikatën e origjines \_\_\_\_\_

B. Nga kontrolli fizik malli i plotëson (nuk plotëson) kërkesat teknike dhe fitosanitare).

Për sa me sipër, mbështetur në Ligjin Nr. 8732, datë 24.01.2001, jam (nuk jam) dakord që të kryhen veprimet e mëtejshme nga organet doganore për kalimin tranzit në doganën pritëse në .....

Vëretje

---

Ky proces verbal mbahet në prani të poseduesit (transportuesit) të materialit mbjelles bimor, në tre kopje, nga te cilat një kopje (kopja e bardhë) i bashkëngjitet dokumentave shoqëruese të mallit (deklaratës tranzit), një kopje (me ngjyrë të kuqe) e mban nëpunësi i doganës dhe një kopje (me ngjyrë të verdhë) e mban Inspektori i Shërbimit të Mbrojtjes së Bimëve.

Inspektori i Shërbimit të Mbrojtjes së Bimëve  
(Karantinës) në pikën doganore

Poseduesi i mallit

**REPUBLIKA E SHOIPËRISË**  
**MINISTRIA E BUJQËSISË DHE USHQIMIT**  
**ENTI SHTETËROR I FARAVE DHE FIDANEVE**  
**Inspektoriati i Kontrollit Shtetëror të Farave**  
**dhe Fidanëve**

**PROVES VERBAL**

**Mbi kontrollin e materialit mbjellës bimor në pikat e kalimit të kufirit dhe  
 lejimit të tij për eksport**

Sot, \_\_\_\_\_ me \_\_\_\_\_ datën \_\_\_\_\_  
 (.....) ditën  
 \_\_\_\_\_, ora \_\_\_\_\_ në pikën e kalimit kufitar \_\_\_\_\_ nga  
 mua z.

....., Inspektor Shërbimit të Mbrojtjes së Bimëve  
 (karantinës), në pikën doganore të ..... në zbatim të Urdhërit Nr.333, datë.  
 26.07.2002, të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, jam ngarkuar dhe përgjigjem për kontrollin e  
 procedurave të importit dhe eksportit të materialit mbjellës bimor, konfirmoj se kam kryer  
 kontrollin fizik dhe dokumentacionin shoqërues të materialit mbjellës bimor Si me poshtë:

1. Materiali mbjellës bimor (fara ose fidana) \_\_\_\_\_.
2. Varieteti \_\_\_\_\_.
3. Riprodhimi \_\_\_\_\_.
4. Klasa \_\_\_\_\_.
5. Sasia \_\_\_\_\_ (ton, kv, kg, copë etj.).
6. Poseduesi i mallit \_\_\_\_\_(subjekti importues).
7. Transportuesi i mallit \_\_\_\_\_(subjekti transportues).
8. Tipi i mjetit dhe targa \_\_\_\_\_.

**Konstatova:**

Materiali mbjellës bimor është (nuk është) shoqëruar me dokumentacionin e plotë teknik sipas kërkesave të ligjit Nr.8732, dt.24.01 .2001, “Per materialin mbjellës bimor”.

**Disponon këto dokumenta:**

1. Çertifikatën fitosanitare \_\_\_\_\_
2. Çertifikatën e garancisë \_\_\_\_\_
3. Flet-analizën lëshuar nga Laboratori i Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, sipas kërkesave të ISTA-s.
4. Materiali është ambalazhuar dhe etiketuar me etiketat zyrtare lëshuar nga Enti Shtetëror të Farave dhe Fidanëve.

Për sa më sipër, mbështetur në Ligjin Nr. 8732, datë 24.01 .2001, jam (nuk jam) dakord që të kryhen veprimet e mëtejshme nga organet doganore për eksportin e materialit mbjellës bimor.

Vërejtje \_\_\_\_\_

Ky proces verbal mbahet ne prani të poseduesit (transportuesit) të materialit mbjellës bimor, në tre kopje, nga të cilat një kopje (kopja e bardhë) i bashkëngjitet dokumentave shoqëruese të mallit (deklaratës tranzit), një kopje (me ngjyrë të kuqe) e mban nëpunësi i doganes dhe një kopje (me ngjyrë të verdhë) e mban Inspektori i Shërbimit të Mbrojtjes së Bimëve.

Inspektori i Shërbimit të  
 Mbrojtjes së Bimëve në Pikat Doganor

Poseduesi i mallit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BUJQËSISË OHE USHOIMIT  
ENTI SI-ITETEROR I FARAVE OHE FIDANEVE  
**Inspektoriati kontrolht shtetëror të  
Farave dhe Fidanëve**

**PROÇES VERBAL**

**Mbi kontrollin e materialit mbjellës bimor në pikat e kalimit të kufirit dhe lejimit të tij për eksport**

Sot, me datën .....  
(..... ) ditën  
....., ora ..... në pikën e katimit kutitar nga  
mua z ..... Inspektor Shërbimit të Mbrojtjes së Bimëve  
(karantinës), në pikën, doganore të ..... në zbatim të Urdhërit Nr.333 datë.  
26.07 2002, të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, jam ngarkuar dhe përgjigjem për kontrollin e  
procedurave të importit dhe eksportit të materialit mbjellës bimor, konfirmoj se kam kryer  
kontrollin fizik dhe dokumentacionin shoqëruar të materialit mbjellës bimor si më poshtë:

1. Materiati mbjellës bimor (fara ose fidana) .....
2. Varieteti .....
3. Riprodhimi .....
4. Klasa .....
5. Sasia ..... (ton kv, kg, copë etj.).
6. Poseduesi i mallit ..... (subjekti importues).
- 7 Transportues mallit ..... ( subjekti transportues).
8. Tipi mjetit dhe targa .....

**Konstatova:**

Material mbjellës binior është (nuk është) shoqoruar me dokumentacionin e plotë teknik sipas kërkesave të lgjit Nr.8732, datë.24.01 .2001, “Për materialin mbjellës bimor”

**Disponon këto dokumenta.**

1. Çertifikatën fitosanitare .....
2. Çertifikatën e garancisë .....
- 3 Ftet-analizën, lëshuar nga Laboratori i Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, sipas kërkesave të ISTA-s.
- 4 Materiali është ambalazhuar dhe etiketuar me etiketat zyrtare Oshuar nga Enit Shtetëror to Farave dhe Fidanëve

Për sa më sipër, mbështetur në ligjin Nr. 8732, datë 24.01.2001, jam (nuk jam) dakord që të kryhen veprimet e metejshme nga organet doganore për eksportin e materiatit mbjellës bimor.  
Vërejtje

---

Ky proces verbal mbahet në prans të poseduesit (transportuesti) të materialit mbjellës bimor, në tre kopje, nga të cilat një kopje (kopja e bardhë) bashkëngjitet dokumentave shoqëruar të mallit (deklaratës transit) një kopje (me ngjyrë to kuqe) e mban nënpunësi doganës dhe një kopje (me ngjyrë të verdhë) e mban Inspektori Shërbimit të Mbrojtjes së Bimëve.

Inspektori i Shërbimit të  
Mbrojtjes së Bimeve në Pikat Doganore

Poseduesi i mallit

## TREGUES E SHENDET TË FARES

A. Sëmundjet dhe demtuesit që përhapen me anë të farës dhe përqindja e lejueshme e tyre.

### 1. Drithrat.

Fara të dritherave nuk lejohen të përdoren për mbjedhje kur:

- përmbajnë fara të barërave të keqia që janë objekt karantinë,
- përmbajnë në një kg farë mbi 5 copë insekte, larva ose vemje të gjalle që demtojnë farën
- përmban me shume se 2 gram qeska urthi për 1 KV farë ose ka shenja infektimi nga

urthi.

- në farera SE dhe E nuk lejohet prekja e urthit.

- përmbari në farën e orizit dhe të tersheres kokrra të zhveshura më shumë se 5%-7%

- në farën e grunt ka prekje nga fuzarioza më shumë se 3%, në farën e orizit nga perikularioza më shumë se 5% dhe në farën e misrit nga fuzarioza më shumë se 5% dhe bakterioza më shumë se 2%.

### 2. Vajore.

Fara të bimëve vajore për mbjellje nuk lejohen kur:

- kanë demtues të gjallë dhe larva që dëmtojnë kulturën

- kur fara e lulediellit është e prekur nga Sclerotinia Libertina dhe Botritis Cinerea në farën e lulediellit

- kur Fusarioza prek farën e sojes jo më shumë se 1% për cilësinë e parë dhe 2% për cilësinë e dytë.

- Kur Bakterioza prek farën e sojes jo me shume se 3% në cilësinë dhe 5% në cilësinë e II

### 3. Duhani

Fara e duhanit nuk lejohet për mbjedhje kur:

-përmban fara të bimëve të karantinës

### 4. Panxhari

Farë panxhari nuk lejohet për mbjedhje kur:

-përmban fara të karantinës, demtues të gjallë dhe sëmundje që demtojnë farën.

### 5. Etero—vajore.

Fara të bimëve etero- vajore nuk lejohen për mbjedhje kur:

- përmbajnë fara të biëve të këqia që janë objekt karantinë

- përmbajnë demtues të gjallë ose larvat e tyre, të cilat demtojnë farën dhe kulturën.

### 6. Foragjerët.

Fara foragjerë nuk lejohen për mbjedhje kur:

- përmbajnë fara që janë objekt karantinë

- përmbajnë demtues të gjallë ose arvat e tyre

### 7. Perime-bostanore-bishtajore

Fara të perimeve —bostanëve —bishtajoret nuk lejohen për mbjedhje kur:

- përmbajnë fara të barërave të karantinës

- përmbajnë demtues të gjallë dhe larva të tyre.

### 8. Patate

Për të aprovuar lejimin e patatës për mbjellje merret për analizë në 400 zharllokë (kokrra) për çdo 100-200 Kv.

Nuk lejohen për mbjellje kur:

- Kroma e zeze + pluhurt kanë prekur zhardhoket mbi 10% të sipërfaqes së tyre dhe mbi 25% të sipërfaqes për kromen e zakonshme.

- Kur zhardhokët dhe sythat janë demtuar në masën 1 0% të sip. së tyre nga dëmtuesit.
- Kur zhardhoket janë prekur nga kalbëzimi i qulltë 1% në shtam dhe SE, 15 në Elit dhe riprodhim të parë, 3% ne riprodhim të tjera.
- Kur zhardhoku është i prekur nga kroma e zezë (Rizoktonia), 2% në shtam dhe SE, 35 Rip. I-re, 5% Rip. të tjera.
- Kur zhardhoku është i prekur nga kroma e zakonshme 2% SE, 3% E dhe Rip. I-re 5%.

Tabela 2

### TOLERANCAT

Mbi shkallën e pastertise dhe te mbirjes te deklaruar në etiketën e prodhuesit dhe ato të analizuara zyrtanisht jane si vijon:

Përqindja e mbirjes e deklaruar nga prodhuesi	Toleranca në përqindje në raport me analizën zyrtare
100/99	1
98/96	2
95/92	3
91/88	4
87/80	5
79/71	6
70/60	7
59/50	8

Përqindja e mbirjes e deklaruar nga prodhuesi	Toleranëa ne përqindje në raport me analizën zyrtare
100	0.8
99	1.0
98	1.2
97	1.3
96	1.4
95	1,5
94	1.6
93	1.7
92	1.9
91/90	2.0
89/85	2.5
84/80	3.5
79/75	3.5













